

**Сторител(и):** Четворица непознати сторители.

**Краток опис на инцидентот со индикатори за пристрасност:** Мотивот на пристрасност во овој инцидент е сексуалната ориентација на жртвата, додека индикатори на пристрасност во овој инцидент се:

1. *Перцепија на жртивата* – жртвата смета дека инцидентот е злосторство од омраза
2. *Локација* – Инцидентот се случил во област позната како област каде што се движат ЛГБТИ.
3. *Природа на насилството* – Инцидентот бил извршен во јавност.
4. *Недостигајок на друѓи мотиви.*

**Статус на случајот:** Непријавен (по избор на жртвата).

**Одговор на надлежните власти:** Н/Д.

**Влијание врз жртвата(ите) и заедницата:** Инциденти од ваков вид ја доведуваат во прашање општата безбедноста состојба на сексуалните малцинства во земјата, особено на оние локации каде што е познато дека се движат.

### 87. Демолирана подрачната канцеларија на ДУИ во Чаир (неверифицирано)

**Што се случило:** Непознати сторители ја демолирале подрачната канцеларија на ДУИ во скопската општина Чаир.

**Датум, време и место на инцидентот:** 24 декември, општина Чаир, Скопје.

**Извор на информацијата:** Националниот електронски медиум „курир.мк“ (албанското издание).

**Вклучена(и) жртва(и):** Освен материјалната штетна, немало директни жртви во овој инцидент.

**Вид на кривично дело(а):** Оштетување туѓи предмети чл. 243 КЗРМ.

**Сторител(и):** Непознат(и).

**Краток опис на инцидентот со индикатори за пристрасност:** Во овој инцидент, мотивот на пристрасност е политичката припадност или политичкото убедување, додека индикаторите на пристрасност се:

1. *Локацијата* – метата е место што има политичко значење за целната група.
2. *Недостигајок на друѓи мотиви.*

**Статус на случајот:** Под истрага.

**Одговор на надлежните власти:** До моментот на пишувањето на овој извештај Полицијата не одговорила на Барањето за информација од јавен карактер што беше испратено од Комитетот во врска со овој инцидент.

**Влијание врз жртвата(ите) и заедницата:** Инциденти од ваков вид ја доведуваат во прашање општата политичка состојба во земјата, и соживотот помеѓу различните групи во општеството.

# RAPORT VJETOR PËR KRIMET NGA URREJTJA NE

NË VITIN  
2014

KRIMEVE TË  
URREJTJES



Ky raport është mundësuar me mbështetjen e Misionit të OSBE-s në Shkup në kuadër të projektit për "Avancimin e infrastrukturës kombëtare kundër krimeve të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes". Përmbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimin apo qëndrimin e Misionit të OSBE-së në Shkup.

**Botues:**

Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë  
përfaqësuar nga Kryetari Prof. Dr. Gordan Kalajxhiev

**Redaktor:**

Uranija Pirovska

**Autorë:**

Voislav Stojanovski, Dr.  
Drilon Iseni, LLM  
Pavle Bogoevski

CIP - Каталогизacija во публикаcija  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

343.542(497.7)(047)  
316.613.43  
343.41/.43(497.7)(047)

STOJANOVSKI, Voislav  
Annual report on hate crimes for 2014  
/ [authors Voislav Stojanovski, Drilon Iseni, Pavle Bogoevski]. -  
Skopje : Helsinki committee for human rights of the Republic of  
Macedonia, 2015. - 83 стр. : илустр. ; 21 см

ISBN 978-608-65216-9-1  
1. Iseni, Drilon [автор] 2. Bogoevski, Pavle [автор]  
а) Говор на омраза - Повреда на човекови права и слободи -  
- Извештаи б) Жртви на дела од омраза - Правна помош -  
- Извештаи  
COBISS.MK-ID 98384650

**KOMITETI I**  
**HELSINKIT**  
**PËR TË DREJTAT E NJERIUT**  
**I REPUBLIKES SE**  
**MAQEDONSE**

Naum Naumovski Borçe 83  
1000, Shkup  
Tel: +389 (0)2 3119 073  
Faks: +389 (0)2 3290 469  
Web: www.mhc.org.mk  
E-mail: helkom@mhc.org.mk

**PËRMBAJTJA**

<b>1. PËR PROJEKTIN</b> .....	76
<b>2. METODOLOGJIA</b> .....	77
2.1 Monitorimi i mediave kombëtare të shtypit dhe atij elektronik .....	77
2.2 Ofrimi i ndihmës ligjore pa pagesë për viktimat .....	77
2.3 Monitorimi i rasteve gjyqësore me përmbajtje të krimeve nga urrejtja .....	77
2.4 Raportimi i krimeve nga urrejtja dhe incidenteve nga urrejtja tek OSBE/ZIDDNJ .....	78
2.5 Mirëmbajtja e një ueb faqeje interaktive për raportimin e krimeve nga urrejtja .....	78
2.6 Sigurimi i informatave dhe burimeve për OSHC-të tjera .....	78
2.7 Pjesëmarrja në trajnime dhe ngjarje të organizuara nga ana e OSBE/ZIDDNJ .....	78
2.8 Monitorimi i krimeve nga urrejtja dhe incidenteve nga urrejtja nëpër ngjarjet sportive .....	79
<b>3. PËRMBLEDHJE E KONKLUZAVE KRYESORE</b> .....	79
3.1 Sfondi .....	79
3.2 Numri i incidenteve .....	79
3.3 Llojet e krimeve .....	80
3.4 Incidente sipas lokacionit .....	81
3.5 Incidentet sipas muajve .....	82
3.6 Incidentet sipas motiveve me paragjykim .....	83
3.7 Viktimat përkundër autorëve të krimit .....	83
3.8 Incidente gjatë ngjarjeve sportive .....	83
3.9 Statusi i rasteve .....	84
<b>4. AKTIVITETET E EKIPIT TË PROJEKTIT</b> .....	85
4.1 Ofrimi i ndihmës ligjore pa pagesë për viktimat .....	85
4.3 Monitorimi i rasteve gjyqësore me përmbajtje të krimeve nga urrejtja .....	87
4.4 Ngritja e vetëdijes .....	88
4.5 Monitorimi i krimeve nga urrejtja dhe incidenteve nga urrejtja nëpër ngjarjet sportive .....	89
<b>5. KONKLUZAT</b> .....	90
<b>6. REKOMANDIME</b> .....	91
<b>SHTOJCË</b> .....	92
<b>INCIDENTET NGA KRIMET E URREJTJES NË 2014</b> .....	92

## 1. PËR PROJEKTIN

Ky raport është rezultat i projektit për “Avancimin e infrastrukturës kombëtare kundër krimeve të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes” i cili ishte i mbështetur financiarisht nga Misioni i OSBE-s në Shkup dhe është realizuar në periudhën nga 1 janari deri në 31 dhjetor të vitit 2014. Qëllimi kryesor i Projektit është të rris kuptimin dhe të përforcojë kapacitetin e aktorëve institucional dhe të shoqërisë civile për tu ballafaquar në mënyrë efektive me krimin nga urrejtja dhe gjuhën e urrejtjes në pajtim me legjislacionin vendor, përkushtimet e OSBE-s dhe Standardet ndërkombëtare. Njëri nga qëllimet kryesore të projektit është të rris kapacitetin e praktikuesve ligjor dhe shoqërisë civile dhe të raportojë dukuritë e krimeve të urrejtjes në vend. Ky raport është i paraparë që të shërbejë si tregues i shtrirjes, natyrës dhe shpeshtësisë së krimeve nga urrejtja në vend.

Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë (KHM) veproi si partner zbatues dhe realizoi aktivitetet në vijim që kishin të bënin me krimet nga urrejtja:

1. Monitorimi i mediave të shtypit dhe atij elektronik
2. Ofrimi i ndihmës ligjore pa pagesë për viktimat
3. Monitorimi i rasteve gjyqësore me përmbajtje të krimeve nga urrejtja
4. Raportimi i krimeve nga urrejtja dhe incidenteve nga urrejtja tek OSBE/ZIDDNJ
5. Mirëmbajtja e një ueb faqeje interaktive për krimet e urrejtjes dhe vetëdijes publike
6. Sigurimi i informatave dhe burimeve për OSHC-të
7. Pjesëmarrja në trajnime dhe ngjarje të organizuara nga ana e OSBE/ZIDDNJ
8. Monitorimi i krimeve nga urrejtja dhe incidenteve nga urrejtja nëpër ngjarjet sportive

## 2. METODOLOGJIA

### 2.1 Monitorimi i mediave kombëtare të shtypit dhe atij elektronik

KHM është i parapaguar në një numër të gazetave ditore me prirje të ndryshme ideologjike dhe përkatësi të ndryshme politike. Monitorimi i mediave elektronike është bërë në bazë ditore, përmes dy gjeneratorëve më të popullarizuar të lajmeve nga interneti (www.time.mk dhe www.grid.mk), si dhe duke përdorur opsionet për kërkim të avancuar nën seksionin “Lajme” të www.google.com. Posa është shënuar një krim nga urrejtja apo incident, KHM ka shënuar titullin e lajmit dhe linkun e internetit dhe e ka botuar tek portali i internetit për raportimin e krimeve nga urrejtja -www.zlostorstvaodomraza.mk. Qëllimi kryesor i monitorimit të mediave ka qenë të identifikojë ngjarje të mundshme të incidenteve nga urrejtja dhe të kontaktojë viktimat e supozuara për intervistë dhe t'u ofrojë ndihmë ligjore pa pagesë apo monitorim të procesit gjyqësor të rastit të tyre.

### 2.2 Ofrimi i ndihmës ligjore pa pagesë për viktimat

Kurdo që një viktimë e supozuar është identifikuar dhe kontaktuar, KHM ka ofruar shërbimet e tija për ndihmë ligjore pa pagesë. Janë organizuar takime me viktimën dhe familjen e tij/saj. Takimet janë realizuar ose në zyrat e KHM-së ose në ndonjë lokacion të propozuar nga ana e viktimës. Gjatë takimit është realizuar edhe një intervistë. Në rastet në të cilat është supozuar të ketë pasur incident/krim, është marrë deklaratë me shkrim, ndërsa nga viktimat është kërkuar të plotësojnë një Kërkesë standarde për ndihmë ligjore pa pagesë. Përveç kësaj, nga viktimat gjithashtu është kërkuar që të bashkëngjisin kopje të dokumenteve përkatëse për rastin e tyre. Mbështetja është ofruar duke i fuqizuar viktimat përmes inkurajimit të tyre, duke i shoqëruar ata deri tek stacioni policor, duke gjetur avokat mbrojtës i cili do t'i përfaqësojë ata pa kompensim në të holla, duke shkruar ankesa penale, duke komunikuar me avokatë të cilët veç më punojnë në raste dhe duke shkruar shkresa në emër të tyre. Është ofruar që të mbikëqyrin rastet e viktimave para dhe pas procesit gjyqësor.

### 2.3 Monitorimi i rasteve gjyqësore me përmbajtje të krimeve nga urrejtja

Monitorimi i procesit nga ana e KHM fillon: 1) pas një kërkesë formale për ndihmë ligjore pa pagesë të dorëzuar në KHM nga ana e personit në procedurën penale në lidhje me krimet nga urrejtja dhe 2) pas informatës së marrë nga gjykatat në lidhje me procedurat gjyqësore të caktuara dhe të vazhdueshme në lidhje me krimet nga urrejtja. Para se të fillojë mbikëqyrësi nga ana e KHM-së të realizojë mbikëqyrjen e procesit gjyqësor, që vijon pas kërkesës formale, personit i cili ka dorëzuar kërkesën i kërkohet që të sigurojë dokumentacionin e plotë në lidhje me rastin e tij/saj (dmth. fotokopje të të gjitha dokumenteve ligjore të marra gjatë procedurave gjyqësore të vendit apo institucioneve tjera). Pasi që janë marrë dokumentet, është caktuar një këshillues ligjor për rastin dhe i është dhënë detyra për të analizuar dhe përcaktuar veprimet e mëtutjeshme të cilat duhet të ndërmerren para, gjatë dhe pas procesit gjyqësor. Këshilluesi gjyqësor pastaj ka përgatitur raportet të cilat i referohen gjithë procedurës dhe ka elaboruar për atë se a është kryer procesi në pajtim me normat ligjore. Monitorimi i proceseve gjyqësore i dha mundësi ekipit të projektit për të vlerësuar mënyrën në të cilën janë të trajtuar viktimat në procesin gjyqësor.

## 2.4 Raportimi i krimeve nga urrejtja dhe incidenteve nga urrejtja tek OSBE/ZIDDNJ

Hollësitë në lidhje me incidentet, siç janë përshkrimi i shkurtër, data, koha, lokacioni, burimi i informatave, viktimat(t) e përfshira, autorët e krimit, statusi i rastit, përgjigja nga autoritetet dhe ndikimi tek viktimat(t) dhe bashkësia, janë raportuar rregullisht tek OSBE/ZIDDNJ Raportimi mbi krimet nga urrejtja dhe incidentet është lehtësuar nga krijimi i një ueb platforme për të bërë rrjetin e krimeve. Krahas asaj që mund të përcillen incidentet e krimeve nga urrejtja onlajn pasi që të ndodhin, OSBE pranon një raport në ndërkohë dhe një raport final të përgatitur nga KHM. Ky raport final do të ndahet me ZIDDNJ për raportin e tyre vjetor për krimet nga urrejtja në vendet anëtare të OSBE-s.

## 2.5 Mirëmbajtja e një ueb faqeje interaktive për raportimin e krimeve nga urrejtja

Ueb portali - [www.zlostorstvaodomraza.mk](http://www.zlostorstvaodomraza.mk) është një vegël interaktive që u mundëson qytetarëve të pranojnë informata dhe raportim për krimet nga urrejtja. Përmban një hartë interaktive që tregon se ku saktësisht apo përafërsisht gjendet lokacioni i incidenteve. Faqja kryesore radhit kategoritë e krimeve nga urrejtja dhe motivet anësore, jep informata në lidhje me mënyrën se si mund të raportojnë qytetarët (e-aplikacionet, twitter, email dhe formën onlajn) dhe paraqet grafikët statistikor. Në ueb portalin gjinden gjithashtu seksionet me Pyetjet me të shpeshta, Burimet dhe Fjalorin, ku janë të dhëna informata në lidhje me projektin, kuptimin dhe shtrirjen e krimeve nga urrejtja dhe botimeve në lidhje me këto krime. Krahas gjuhës maqedonase, portali është gjithashtu edhe në gjuhën angleze dhe shqipe.

## 2.6 Sigurimi i informatave dhe burimeve për OSHC-të tjera

KHM organizoi një konferencë për shtyp për të prezantuar Analizat e veçanta për krimet nga urrejtja për vitin 2013, në maj të vitit 2014. Ftesa për konferencën për shtyp është dërguar tek më shumë se 50 OJQ. Një numër i përfaqësuesve të OJQ-ve dhe institucioneve shtetërore morën pjesë në konferencë dhe u informuan për mundësinë për të përdorur KHM-në si qendër për burime mbi krimet nga urrejtja. Gjatë kohëzgjatjes së projektit, KHM është kontaktuar nga Organizata ndërkombëtare për migrim dhe ILGA Evropë. Ata kërkuan dhe morën statistikën në lidhje me krimet nga urrejtja për vitin 2013. KHM, Metamorfoza, Forumi rinor i Maqedonisë dhe Instituti për media i Maqedonisë (OSHC lokale) janë duke punuar së bashku mbi çështjet të cilat përfshijnë krimet nga urrejtja dhe gjuhën e urrejtjes. Përveç kësaj, KHM ka hapur një faqe për vetëdijesim për krimet nga urrejtja në Facebook (<http://goo.gl/8yY5Lk>), një faqe në Twitter (<https://twitter.com/HateCrimesMK>) dhe ka futur një seksion të veçantë mbi krimet nga urrejtja në raportet e saja mujore mbi situatën me të drejtat e njeriut në shteti të cilat janë të shpërndara tek institucionet shtetërore, mediat, OJQ-të, organizatat ndërkombëtare dhe ambasadat e huaja në vend.

## 2.7 Pjesëmarrja në trajnime dhe ngjarje të organizuara nga ana e OSBE/ZIDDNJ

Me qëllim avancimin e mëtutjeshëm të njohurisë së saj institucionale për krimet nga urrejtja, anëtarët e ekipit të projektit morën pjesë në një numër të madh të trajnimeve dhe ngjarjeve të organizuara nga OSBE/ZIDDNJ në shteti dhe Serbi. Krahas pjesëmarrjes në trajnime dhe ngjarje të organizuara nga OSBE-ja, anëtarët e ekipit të projektit morën pjesë në ngjarje të shumta publike dhe profesionale që kanë të bëjnë me krimet nga urrejtja në shteti, rajonin e Ballkanit perëndimor (Shqipëri, Bosnje, Kosovë dhe Serbi) dhe Evropë (Greqi, Belgjikë dhe Gjermani).

1) Në dispozicion në: <http://www.mhc.org.mk/analysis/209>

## 2.8 Monitorimi i krimeve nga urrejtja dhe incidenteve nga urrejtja nëpër ngjarjet sportive

Janë monitoruar ndeshjet me rrezik të rritur të dhunës (ndeshjet sportive vendore dhe ndërkombëtare me një rëndësi më të lartë konkurrence, ndeshjet sportive gjatë të cilave pritet një pjesëmarrje më e madhe në numër dhe ndeshjet sportive ku pjesëmarrja e tifozëve të klubeve mysafire është ndaluar). Për këtë qëllim, janë zgjedhur ndeshjet të cilat janë etiketuar si ndeshje me rrezik të lartë gjatë vitit 2013. Monitoruesit arrinin në vendin e ngjarjes sportive një orë para se të fillonte ndeshja dhe vështronin se vallë a kërkonte shërbimi portier nga tifozët që ti tregojnë biletat e tyre, nëse bënin kontroll gjatë hyrjes, nëse tifozët përiqeshin të futen duke bartur pajisje dhe gjëra të cilat janë të ndaluara të futen në këto hapësira; dhe masat e ndërmarra nga nëpunësit policor për ndarjen fizike të tifozëve të ekipeve garuese.

# 3. PËRMBLEDHJE E KONKLUZAVE KRYESORE

## 3.1 Sfondi

Krimet nga urrejtja në Rajonin e OSBE-së - Incidente dhe Përgjigje: Raporti vjetor për vitin 2012 shënon se në periudhën midis 2008-2012 “51 Shtete pjesëmarrëse kanë informuar ZIDDNJ-në se kanë grumbulluar ca të dhëna mbi krimet nga urrejtja. Ish Republika Jugosllave Republika e Maqedonisë ka deklaruar se nuk grumbullon kurrfarë statistikash të këtij lloji.”<sup>2</sup> Portali i internetit për raportimin e krimeve nga urrejtja i OSBE/ZIDDNJ 2013 shënon se Ish Republika Jugosllave Republika e Maqedonisë ka raportuar tek ZIDDNJ se nuk grumbullon të dhëna për krimet nga urrejtja.”<sup>3</sup> Krahas kësaj, është deklaruar në Raportin e progresit të Komisionit Evropian 2014 për Ish Republika Jugosllave Republikën e Maqedonisë se “Të dhënat për raportimin, hulumtimin dhe përndjekjen e krimeve nga urrejtja nuk grumbullohen në mënyrë sistematike ndërsa trajnimi i zbatuesve të ligjit, prokurorëve dhe gjykatësve duhet të intensifikohet.”<sup>4</sup> Në vitin 2014, Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë botoi një analizë të veçantë mbi krimet nga urrejtja të regjistruar midis periudhës së marsit dhe dhjetorit të vitit 2013.<sup>5</sup> Kjo analizë, së bashku me këtë raport dhe ueb portalin për raportimin e krimeve nga urrejtja - [www.zlostorstvaodomraza.com](http://www.zlostorstvaodomraza.com), përfaqësojnë përpjekjet e para për të hartëzuar, monitoruar dhe raportuar mbi incidentet e krimeve nga urrejtja në vend.

## 3.2 Numri i incidenteve


Gjatë periudhës 1 janar - 31 dhjetor 2014, janë regjistruar gjithsej 87 krime nga urrejtja dhe incidente. 12 incidente janë raportuar tek KHM nga ana e viktimave, përderisa të gjitha incidentet tjera

2) OSBE/ZIDDNJ, Krimet nga urrejtja në Rajonin e OSBE-së - Incidente dhe Përgjigje: Raporti vjetor për vitin 2012, Varshavë, nëntor 2013, fq. 16-17. Në dispozicion në: [http://tandis.odhr.pl/hcr2012/pdf/Hate\\_Crime\\_Report\\_full\\_version.pdf](http://tandis.odhr.pl/hcr2012/pdf/Hate_Crime_Report_full_version.pdf)

3) Në dispozicion në: <http://hatecrime.osce.org/former-yugoslav-republic-macedonia> (shih vërejtjet kryesore të ZIDDNJ).

4) Komisioni Evropian, Raporti i progresit për ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë 2014, Bruksel, tetor 2014, fq. 13.


5) Në dispozicion në: <http://www.mhc.org.mk/analysis/209>



janë raportuar nga ana e mediave. 46 incidente janë verifikuar me anë të kontakteve me policinë, buletin policor, raportimet e mediave, takimet me viktimat dhe duke e dëshmuar incidentin në vendin e ngjarjes. 41 nga viktimat e regjistruara nuk janë verifikuar, por sidoqoftë janë përfshirë në raport për shkak të ekzistimit të treguesve anësorë duke përfshirë: perceptcionin e viktimës/dëshmitarit; Komenteve të bëra në vendin e ngjarjes; Dallimin midis viktimës dhe kryerësit të veprës mbi baza etnike; Modeli/shpeshtësia e in-

cidenteve të më para; Natyra e dhunës; Mungesa e motiveve tjera; dhe lokacioni dhe koha (tajmingu) Më saktësisht, incidentet e pa verifikuar janë përfshirë për shkak se informata e marrë në lidhje me lokacionin e incidentit (p. sh. lagjet dhe shkollat etnikisht të përziera, linjat e autobusit të përdorura nga anëtarë të bashkësive të ndryshme etnike, vendet ku kanë ngjarë krime nga urrejtja në të kaluarën etj.), lloji i incidenteve (p. sh. një grup më i madh i të rinjve sulmojnë një apo më shumë viktimë pa provokime, përlëshje të grupeve, sulme në një autobus apo një stacion autobusi etj.), koha e incidentit (duke pasuar ndonjë përlëshje të mëhershme si një formë hakmarrjeje, pas orarit shkollor, gjatë apo pas ndonjë ngjarjeje sportive etj.) dhe prona e dëmtuar gjatë incidentit (p. sh. kisha dhe varreza). Raportet e pa verifikuar dhe ato të verifikuar mund të shihen në mënyrë të ndarë në ueb portalin për raportim të krimeve nga urrejtja. Në Anexin e këtij raporti, titujt e incidenteve të verifikuar janë të nënvizuara me të gjelbër përderisa titujt e incidenteve të pa verifikuar janë me të kuqe.

### 3.3 Llojet e krimeve





Shumica e krimeve janë kryer nga ana e të rinjve. Viktimat dhe kryerësit e veprave janë zakonisht anëtarë të grupeve të ndryshme etnike (maqedonas dhe shqiptar). Llojet më të shpeshta të krimeve të kryera përfshijnë: sulme, posedim dhe përdorim të armëve të paligjshme, dëmtime në pronë, vandalizëm, kërcënime dhe dhunë. Incidentet e regjistruara janë lidhur gjithashtu edhe me shkeljen e supozuar penale siç është e përshkruar nga ana e Kodit penal. Shumica e shkeljeve të supozuara penale përfshijnë: Dëmtime trupore (47), Dhunë (46), Dëmtime në pronë (31), Rrezikimin e sigurisë (30) dhe Pjesëmarrje në përlëshje (21).



Përveç kësaj, një numër i incidenteve bie nën veprat e pretenduara penale në vijim: Nxitja e urrejtjes, mosmarrëveshje dhe jotolerim mbi bazë racore, fetare apo tjetër diskriminuese (8), Rrezikim me anë të mjeteve të rrezikshme gjatë një përlëshjeje apo mosmarrëveshjeje (6), Sulmi i ndonjë zyrtari publik duke kryer çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë (4) dhe vandalizimi i varrezave (3). Shumë shpesh veprat penale të kryera në një incident plotësojnë kriteret për dy apo më tepër shkelje penale dhe prej këtu del dhe numri më i madh i shkeljeve të cilat janë prezantuar si incidente në këtë nëntitull.

### 3.4 Incidente sipas lokacionit



Pjesa më e madhe e incidenteve (84%) kanë ndodhur në Shkup dhe në zonën e saj metropolitane. Janë regjistruar 4 incidente në Manastir, 3 në Kumanovë dhe Prilep, 2 në Manastir dhe 1 incident në Makedonska Kamenica.



Qytetet në të cilat kanë ndodhur numri më i madh i incidenteve janë në rajone në të cilat ekziston një pakicë e mjaftueshme e, qoftë maqedonasve etnik (Tetovë), apo shqiptarëve etnik (Shkup dhe Kumanovë). Për dallim nga 2013, nuk ka pasur incidente të regjistruara në qytetet me larmi etnike të Gostivarit, Kërçovës dhe Strugës. Si në vitin 2013, nuk ka pasur incidente të regjistruara në Dibër.




Përveç në Saraj, një komunë e banuar kryesisht me shqiptar etnik, krimet nga urrejtja kanë ndodhur në të gjitha 9 komunat tjera të Shkupit. Shumica e incidenteve kanë ngjarë në Çair (15), Qendër (13), Aerodrom dhe Gazi Babë (9) dhe Butel e Karposh (8). Çairi dhe Buteli janë kryesisht të banuara me shqiptar etnik, përderisa maqedonasit etnik janë shumicë në komunat tjera. Nuk ka pasur asnjë krim të vetëm të regjistruar kundër romëve. Fakti se nuk ka incidente të tilla nuk domethënë medemos se ato nuk ngjajnë, por se mund të mos jenë të raportuara.



Një minimum i 11 incidenteve në Shkup ka ngjarë në autobusë (ndonjëherë mediat kanë raportuar lokacionin se ku është sulmuar autobusi por jo edhe numrin e tij). Shumica e autobusëve lëvizin midis lagjeve të cilat janë të banuara nga maqedonas dhe shqiptar etnik.


Një minimum i 13 incidenteve kanë ngjarë brenda apo në afërsi të 7 shkollave të mesme në Shkup: Zef Lush Marku (4), Mari Skłodovska-Kiri (3), Zdravko Cvetkovski (2) dhe një incident në Vlado Tasevski, Cvetan Dimov, Krste Misirkov dhe Kiril Pejčinoviç. Incidentet përfshijnë një sulm të një grupi nxënësish kundrejt një nxënësi të vetëm apo përlëshje midis dy grupeve kundërshtuese. Tre nga këto shkolla gjinden në bulevardin e njëjtë në Komunën e Aerodromit. Në të gjitha shkollat ka edhe nxënës maqedonas edhe shqiptar. Krahas këtyre lokacioneve ku krimet nga urrejtja ngjajnë rregullisht, janë përdhosur dy varreza (njëri në Komunën e Gjorçe Petrovit dhe tjetri në fshatin Loveni, Prilep).

### 3.5 Incidentet sipas muajve



Prilli ishte muaji në të cilin kanë ndodhur numri më i madh i incidenteve - 23 (26% nga të gjitha incidentet e vitit të kaluar). Arsyeja për këtë rritje të pazakontë mund ti atribuohet Zgjedhjeve të parakohshme parlamentare dhe Zgjedhjeve presidenciale. Duhet sidoqoftë të shënohet se në 2013tën, incidentet e këtilla nuk kanë ngjarë gjatë Zgjedhjeve lokale. Sidoqoftë, kjo rritje në incidentet që kanë të bëjnë me urrejtjen për shkak të besimit apo përkatësisë politike është një tregues i qartë i situatës delikate politike, etnike dhe të sigurisë në shteti. 14 incidente janë regjistruar në shkurt. Shumica e këtyre incidenteve kanë përfshirë të rinjtë të cilët janë përlëshur në shkolla apo autobusë. Këto incidente kanë vazhduar në mars (8) dhe prill dhe ishin më të pakta në numër në muajt që kanë pasuar. Arsyeja për këtë zvogëlim pozitiv mund të jetë për shkak të faktit se nëpunësit policor kanë qenë në mënyrë të vazhdueshme prezent dhe janë parë nëpër shkolla dhe në afërsinë e tyre si dhe në stacionet e autobusit dhe nëpër autobusë.

### 3.6 Incidentet sipas motiveve me paragjykim




Shumica e krimeve nga urrejtja (61%) ndodhin përshkak të përkatësisë së ndryshme etnike të viktimës. Pothuajse të gjitha këto incidente përfshijnë maqedonas dhe shqiptar etnik. Përkatësia politike (23%), orientimi seksual (10%) dhe përkatësia fetare (6%) përfaqësojnë pjesën tjetër të motiveve nga paragjykimet për shkak të të cilave kryhen krimet nga urrejtja në shteti. Në 8 incidente pretendohet të jetë kryer shkelja penale “Shkaktim i urrejtjes kombëtare, racore apo fetare, mospajtim apo jotolerancë”, përderisa për incidentin në Café

Damar (shih Incidentin nr. 77 në Aneks), pretendohet shkelja penale “Racore apo diskriminim tjetër”.

### 3.7 Viktimat përkundër autorëve të krimit


Ka pasur minimum 125 viktima dhe 496 autorë të krimeve nga urrejtja gjatë vitit. Kudo që është dhënë numër i pacaktuar i autorëve të krimeve (p. sh. midis 10 dhe 15) në media, vlera më e vogël është përdorur për këtë raport. Kurdo që është raportuar që një “grup” i autorëve të krimeve anë kryer një krim nga urrejtja, vlera e përdorur për këtë raport ka qenë 3 persona. Numri më i madh i viktimave janë të rinj të gjinisë mashkullore. Viktima më e re është 10 vjeçare. Midis viktimave, ka edhe 5 vajza të reja (por me siguri edhe më shumë duke marrë parasysh faktin se mediat zakonisht raportojnë krimet nga urrejtja si kundër një “gru-



pi” të të rinje)..

### 3.8 Incidente gjatë ngjarjeve sportive


Gjashtë incidente të krimit nga urrejtja janë kryer nga tifoz të 4 klubeve futbolistike dhe 3 klubeve të basketbollit. Incidentet zakonisht përfshijnë përlëshje midis tifozëve të dy ekipeve kundërshtuese me lojtar etnik shqiptar dhe maqedonas. Krahas tifozëve, ndonjëherë edhe anëtarët e ekipeve mysafire kanë qenë gjithashtu viktima. Gjatë ndeshjeve ku ka pasur ekipe të tilla, është dëgjuar gjuha e urrejtjes në këndimet nga ana e përkrahësve lokal. Këto ngjarje janë zakonisht të konsideruara si “ndeshje me rrezik të lartë” nga federata përkatëse e sportit, që do të thotë se pjesëmarrja e tifozëve të ekipit misafir është e ndaluar. Autoritetet duket se imponojnë në mënyrë strikte këtë rregull duke caktuar një numër të



ndaluar. Autoritetet duket se imponojnë në mënyrë strikte këtë rregull duke caktuar një numër të

madh të nëpunësve policor, të dukshëm nëpër rrugët midis qyteteve/komunave në të cilat po ndodh ngajrja, në vendet e hyrjes në qytetet si dhe në afërsi dhe brenda stadiumeve të futbollit. Krimet nga urrejtja, krahas ndikimit dëmtues që kanë mbi sigurinë e qytetarëve, duket të kenë edhe ndikim negativ mbi segmentet e tjera të shoqërisë, duke përfshirë edhe sportin.

### 3.9 Statusi i rasteve



Policia ka gjetur kryerësit e dyshimtë të minimum 35 nga 87 incidentet. Një minimum i 30 incidenteve tjera janë raportuar në polici dhe janë nën hetime. Duke marrë parasysh se nuk ka bazë të të dhënave për krimet nga urrejtja, rastet e zgjedhura janë regjistruar duke kontaktuar me policinë, duke monitoruar mediat dhe duke qenë të informuar drejtpërdrejt nga ana e viktimave. Nuk ka pasur informata në lidhje me statusin e 16 rasteve të incidenteve për shkak të zgjedhjes së viktimave (zakonisht në krimet e supozuara të kryera për shkak të orientimit seksual apo si motiv paragjykimesh). Sipas përgjigjeve të marra nga Ministria e punëve të mbrendshme, 21 incidente rezultuan me kallëzime penale, 14 me akuza kundërvajtëse, 10 incidente nuk ishin të regjistruara, përderisa për 3 incidente nuk kishte përgjigje. KHM regjistroi vetëm 3 incidente të cilat nuk janë përpunuar në gjykatë.

## 4. AKTIVITETET E EKIPIT TË PROJEKTIT

### 4.1 Ofrimi i ndihmës ligjore pa pagesë për viktimat

KHM ofroi ndihmë pa pagesë ligjore për viktimat në katër raste dhe vazhdoi t'i sigurojë ndihmë ligjore pa pagesë Zr. Koço Andonovski, drejtor i programit të Qendrës për LGBTI në Shkup, degë e KHM-së.

#### 1. Incidenti në Radishan, Shkup

Kërkesa e parë është dorëzuar nga ana e njëres nga viktimat pas një përleshjeje masive midis maqedonasve dhe shqiptarëve etnik në Radishan, në Shkup, gjatë zgjedhjeve. Në prill, një grup i meshkujve maqedonas, pas përfundimit të votimit të raundit të parë për Zgjedhjet presidenciale, filloi të ofendojë, të shajë dhe pas kësaj të sulmojë dhe rrahë një familje shqiptare me banim në Radishan. Njëri nga autorët e krimit ka çuar makinën drejt një grupi viktimash (shih Incidenti 39 në Aneks). Në maj, një bombë ka eksploduar në banjën e familjes së njëjtë (shih Incidenti 55 në Aneks).. Kontakti i familjes është marrë nga mediat të cilat raportuan për incidentin e parë. Pas incidentit të dytë, familja është kontaktuar edhe njëherë, me ftesë që një përfaqësues të takohet me përfaqësuesit e KHM-së. Viktima e informoi KHM-në se rreth dymbëdhjetë familjarë të tij janë larguar nga shteti dhe kanë bërë kërkesa për azil në Gjermani. Njëri nga viktimat është kapur nga policia dhe është dënuar me burgim 6 mujour (gjykimi ende nuk është final) në një proces gjyqësor i cili ka zgjatuar vetëm një ditë. Viktimat nuk ishin të ftuara të merrnin pjesë në procesin gjyqësor, as si dëshmitarë e as si palë e dëmtuar. Viktima insistonte që KHM të mos veprojë në emrin e tij, duke u frikësuar për sigurinë personale.

#### 2. Incident në Barin New Orleans, Shkup

Incidenti i dytë në të cilin është ofruar ndihmë ligjore ka ndodhur në 5 gusht, 2014. Një grup i rreth dhjetë autorëve, janë përfshirë në një fjalosje rreth mesnatës, e cila ka rezultuar me goditje të Barit New Orleans në Çarshinë e vjetër në Shkup (shih Incidenti 63 në Aneks). Njëri nga kryerësit e veprës ka kërkuar nga DJ të mos lëshojë muzikë maqedonase. Kryerësit e veprës kanë qenë anëtarë të klubit të tifozëve të futbollit "Shvercerët" ("Kontrabandistë"). Deri në vitin 2012 "Shvercerët" kanë përkrahur KF Sloga Jugomagnat nga Komuna e Çairit gjatë së cilës kohë klubi është bashkuar me KF Albarsa për të formuar KF Shkupi (tani garon në Ligën e dytë të Maqedonisë). Një përfaqësues i KHM-së e takoi pronarin e barit personalisht dhe i ofroi ndihmë ligjore pa pagesë. Pronari, sidoqoftë, duke u frikësuar se publiciteti i incidentit vetëm do të përkeqësonte punët, refuzoi që KHM të veprojë në emrin e tij. Në këtë incident autoritetet gjetën dy nga kryerësit e veprës. E gjithë procedura penale zgjati vetëm 18 ditë. Njëri nga të akuzuarit është dënuar me një vit burgim, ndërsa i dyti është dënuar me dy vjet dënim me kusht. Ndryshe nga rastet e tjera ku interesi i publikut është i lartë, Gjykata themelore në Shkup nuk ka botuar një kumtesë për shtyp në ueb faqen e tyre për datën e gjykimit. Publiku është informuar për rezultatin pasi që është kryer procesi një ditë gjyqësor.

#### 3. Incidenti në Gjorçe Petrov, Shkup

Incidenti i tretë në të cilin është ofruar ndihmë ligjore ka ndodhur më 29 gusht, 2014 në Gjorçe Petrov në Shkup (shih Incidenti 70 në Aneks).. KHM është takuar me viktimën, restoranti i të cilit ishte djegur gjatë ngjarjeve të dhunshme në Gjorçe Petrov (shih Incidenti 56 në Aneks). Viktima na informoi se raporti policor u është dhënë të gjithëve që janë dëmtuar me këtë rast me përjashtim të tijin. Sipas tij, ai dhe familja e tij janë viktimë të presionit etnik dhe politik. Në fund të gushtit, një grup më i madh i personave, janë grumbulluar afër restorantit të tij duke u përpjekur për të thyer xhamat. Pasi që e ka vërejtur se çfarë po ndodh, ai ka mbyllur dritaret dhe e ka thirrur policinë pas çka grupi është larguar. Sipas viktimës, djali i tij së bashku me shokun e tij janë sulmuar në të kaluarën në dy raste të ndryshme nga një grup personash të cilët i kanë goditur me tullë. Babai i tij, i cili është 70 vjeçar, me aftësi të kufizuara, është sulmuar nga të rinjtë e lagjes së tij duke ia lënduar shpinën. Pasi që i është ofruar ndihmë ligjore pa pagesë për të gjitha incidentet e supozuara, viktimë kërkoi nga ne që të mos ndërmarrim veprime për shkak se kjo “do ta kapte në grackë për një shkelje penale” dhe do ti shkaktonte probleme me policinë.

Mund të konkludohet nga këto tre raste se viktimat nuk dëshirojnë që t'u përmendet emri, as publikisht e as para institucioneve shtetërore, duke u frikësuar nga pasojat. Kjo çon kah mos raportimi i duhur i krimeve nga urrejtja për shkak të mungesës së besimit tek sistemi nga populli.

#### 4. Incidenti në Café Damar, Shkup

Incidenti i katërt në të cilin është ofruar ndihmë ligjore ka ndodhur më 23 tetor, 2014 në ora 21:30. Një stampede e rreth tridhjetë të rinjve të përshpejtuar me shpejtësi të rrufesë nga të dy anët e rrugës të cilat çojnë kah Cafe Damar, ku kanë qenë duke festuar dy vjetorin e ekzistimit, Qendra për mbështetje të LGBTI, degë e KHM-së, (shih Incidenti 77 në Aneks). Duke mbajtur kësula mbi kokët e tyre dhe të armatosur me shishe xhami dhe objekte të tjera të forta, huliganët kanë gurëzuar Café-në, dhe me shpejtësinë me të cilën janë paraqitur, janë zhdukur nëpër sokakët e afërt. Gjatë kohës së incidentit, më shumë se gjashtëdhjetë persona kanë marrë pjesë në festim, dy persona, nga të cilët një i ri dhe një grua, kanë qenë duke qëndruar jashtë para hyrjes kryesore. Ata ishin rrahur dhe sulmuar nga grupi i dhunshëm me shishe xhami dhe kanë marrë lëndime në kokat dhe trupat e tyre. Gjatë rrahjes, sulmuesit tërë kohës u kanë thënë që duhet të shkojnë dhe se pederastët nuk janë të mirëseardhur këtu. Një përfaqësues i KHM i ka shoqëruar viktimat deri tek spitali ku u është marrë deklarata dhe u është ofruar ndihmë ligjore pa pagesë. Njëri nga viktimat u pajtua më vonë që KHM të përgatis një ankesë penale në emër të saj. Ankesa penale është paraqitur tek Zyra e prokurorisë publike në Shkup.

#### 5. Incident gjatë “Marshit për tolerancë” në Shkup në vitin 2012

Incidenti i fundit në të cilin është ofruar ndihmë ligjore ka ndodhur në 17 nëntor, 2012. KHM organizoi “Marshin e tolerancës” në të cilën kohë është shënuar Dita ndërkombëtare e tolerancës. “Marshi për tolerancë” filloi me një sulm fizik kundrejt dy aktivistëve për të drejta të njeriut - njëri nga të cilët z-ri Koço Andonovski - gjatë përgatitjes së stendave për OJQ-të të cilat e përkrahnin këtë ngjarje. Policia kapi autorin menjëherë pas incidentit, por procesi gjyqësor filloi në janar të vitit 2014 (për informata të tjera në lidhje me procesin gjyqësor dhe ofrimin e ndihmës ligjore pa pagesë shih aktivitetit 3.3 më poshtë).

### 4.3 Monitorimi i rasteve gjyqësore me përmbajtje të krimeve nga urrejtja

KHM dërgoi një kërkesë për informata tek stacionet policore dhe zyrat e Prokurorit publik për çdo incident që ka shënuar. Kjo është bërë me qëllim që të verifikohet se ka ndodhur në të vërtetë regjistrimi i një krimi nga urrejtja apo të informohet se a është caktuar datë për gjyq për rastet në të cilat janë kapur kryerësit e veprave. Nga 67 kërkesat e dërguara tek stacionet policore anembanë vendit, janë marrë 64 përgjigje (96% nga shkalla e përgjigjes) gjatë vitit 2014.

Sipas përgjigjeve, shumica e incidenteve janë regjistruar dhe janë proceduar si kundërvajtëse. Policia nuk i është përgjigjur 3 kërkesave për informata. Ato që ishin përgjigjur nuk jepnin numrin e ankesave penale të cilat janë dërguar tek zyrat e Prokurorisë publike. Pas një kërkesë për informatë të dërguar tek zyra e Prokurorit publik në Shkup, Zyra e informoi KHM-në se fakti që kanë dhënë vendin, datën dhe kohën e incidentit nuk mjafton për ta, që të na japin informata në lidhje me aktivitetet që ata i kanë ndërmarrë për incidentin në fjalë. Sipas Zyrës, ata kanë nevojë për emrat e të akuzuarve apo për emrin e dorëzuesit të ankesës penale. Sidoqoftë, duke marrë parasysh se emrat e të akuzuarve nuk konsiderohen si informatë publike, KHM nuk kishte zgjedhje tjetër, përveç se të dërgojë të dhënat publike të cilat janë marrë nga Sektori për punë të brendshme i qytetit të Shkupit (SPM) në lidhje me 11 incidente për të cilat stacionet lokale pozitive kanë dorëzuar ankesa penale tek zyra e Prokurorit publik në Shkup. Këto të dhëna përmbajnë inicialet e të akuzuarve dhe emrin e dorëzuesit të ankesës penale - SPM. Në përgjigjen e saj, zyra e Prokurorit publik na informoi se nuk është e mundur që ata të ekzaminojnë dosjet dhe të verifikojnë nëse janë duke i hetuar apo i kanë proceduar ato në gjyq. Sipas Zyrës, ata i kanë dërguar të dhënat tek SPM me qëllim që të marrin informata tjera në lidhje me ankesat penale të dorëzuara nga ana e policisë.

#### 1. KHM dhe Koço Andonovski

KHM ka monitoruar procesin gjyqësor K.nr.1644/13 në Shkup. Ky proces ka të bëjë me orientimin seksual si bazë mbi të cilën kryerësi i veprës e ka sulmuar z-ri Koço Andonovskin, drejtor i programit të Qendrës së LGBTI në Shkup, në sheshin kryesor të qytetit të Shkupit në vitin 2012. Duke marrë parasysh se KHM konsideron këtë rast si rast strategjik, ia arriti të sigurojë avokat mbrojtës që t'i përfaqësojë viktimat pa pagesë. Ky rast përfshin këto akuza penale: Dhunë (paditur nga Shteti), Pengim i një tubimi publik (paditur nga KHM) dhe lëndim i barazisë së qytetarëve (paditur nga z-ri Andonovski dhe aktivistët e tjera të lënduar të të drejtave të njeriut). Zyra e Prokurorit publik iu bashkëngjiti rastit në v. 2014, pas hetimeve të bëra mbi këtë rast për një vit e gjysmë. Vendimi është shpallur në janar të vitit 2015. Kryerësi i veprës është dënuar me 7 muaj burgim nga gjykata themelore për Dhunë dhe pengim të një tubimi publik, por padia për lëndim të barazisë së qytetarëve është shkarkuar nga gjykata. Vendimi i gjykatës themelore nuk i referohet veçanërisht Nenit 35(9) të Kodit penal (rrethanat rënduese në dënim si rezultat i shkeljes penale të kryer nga paragjykimi). Vendimi është dërguar në gjykatë më të lartë për apel nga ana e të akuzuarit.

#### 2. Protestat pas vendimit gjyqësor në rastin “Monstra”

Më 4 korrik të vitit 2014, pas prononcimit publik të vendimit gjyqësor në rastin e ashtuquajtur “Monstra” në të cilin 6 të pandehurit (pjesëtarë të bashkësisë etnike shqiptare në shteti), ishin të dënuar me burgim jetësor nga gjykata themelore në Shkup, ndeshje të dhunshme midis afro 3,000 protestuesve dhe policisë eruptuan para gjykatës. Protestat rezultuan me dëme të konsiderueshme materiale të gjykatës themelore dhe civile në Shkup. Krahas kësaj, rreth 20 nëpunës policor janë lën-



duar, 5 nga të cilët kanë marrë lëndime serioze. KHM mbikëqyri procesin K.nr.2242/14 në Shkup, në të cilin 6 protestues ishin paditur për kundërvajtje “Pjesëmarrje në turmë që kryen krim”. Gjatë procesit gjyqësor është vërejtur se prokurori publik e ka udhëhequr gjykatësin për dispozitat e zbatueshme në proces. Krahas seancës së parë, pjesa tjetër e procesit është zhvilluar në një dhomë të vogël të gjykatës së cilës i mungonin standarde minimale hapësinore duke e vështirësuar pjesëmarrjen e avokatëve dhe publikut në proces. Në seancën e provave kur janë projektuar videot e kamerave të sigurisë, mediave dhe publikut u është dhënë qasje me vonesë. Për shkak të kësaj arsyeje, monitoruesi nga KHM nuk mund të shikonte tërë videon por pjesën të cilën e ka shikuar nuk e ka treguar të akuzuarin duke kryer krimin. Gjatë seancës finale, gjykatësi ka dhënë vendimin duke i caktuar dënim me burgim prej 3 vitesh (dënimi maksimal për këtë shkelje) për gjashtë persona nga 8 të pandehurit dhe u urdhëroi që bashkërisht të paguajnë dëmet. Gjykata e Apelit në Shkup konfirmoi vendimin, duke e zvogëluar dënimin në dy vjet e gjysmë burgim. Për një rast të ngjashëm por jo aq të dhunshëm në Tetovë, ku banorët e Tetovës protestuan kundër vendimit të rastit “Monstra”, Gjykata themelore e Tetovës dënoi të pandehurit me nga dy vjet e gjysmë dënim me kusht.

Krahas kësaj, KHM monitoroi rastin “Monstra” në lidhje me vrasjen e pesë personave (katër nga të cilët ishin djelmosha të rinj të moshës prej 20 dhe 22 vjeçare) në liqenin afër fshatit Smillkoc në Shkup. Rasti filloi në vitin 2013. Janë monitoruar 12 seanca gjatë periudhës së raportimit në vitin 2014. Tani rasti po shqyrtohet nga Gjykata e apelit në Shkup. Në vendimin e Gjykatës themelore është deklaruar se të pandehurit shqiptar kanë zgjedhur me qëllim viktimat e tyre që të jenë anëtarë të bashkësisë etnike maqedonase.

### 3. Vrasja në Gjorçe Petrov

Pas vrasjes së një të riu maqedonas nga një i ri shqiptar në një incident që kishte të bënte me vjedhje, provokoi protesta masive në lagjen e Gjorçe Petrovit. Shumë maqedonas etnik konsideronin se vrasja ishte për shkak të përkatësisë së ndryshme etnike të viktimës dhe autorit, edhe pse deri më sot nuk ka prova apo tregues të tjerë anësor që të konsiderojmë këtë rast si krim nga urrejtja. KHM i monitoroi protestat e dhunshme në Gjorçe Petrov dhe vendosi që të monitorojë edhe procesin gjyqësor që të sigurohet se kjo nuk do të shkatërrojë më tej raportet ndër-etnike midis shqiptarëve dhe maqedonasve në vend, sidomos midis rinisë shqiptare dhe maqedonase. Procesi është në vazhdim e sipër dhe do të mbikëqyret deri në fund.

### 4.4 Ngritja e vetëdijes

KHM shënoi 22 korrikun - ditën Evropiane për viktimat e krimit nga urrejtja duke organizuar dy ngjarje të ndryshme. Ngjarja e parë përbëhej nga një konferencë për shtyp për mediat dhe një projektim të një filmi të shkurtër kushtuar viktimave të krimeve nga urrejtja në shteti.<sup>6</sup> Artikuj, fotografi dhe video nga krimet aktuale të kryera nga urrejtja ishin të përdorura në këtë video të shkurtër. Videoja kishte titra në shqip dhe anglisht. Ngjarja e dytë ishte e organizuar në parkun e qytetit në Shkup. Ishte e titulluar “Turlitavë-është më e shijshme së bashku” dhe përfshinte fjalime, muzikë, shoqërim midis pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme etnike duke degustuar ushqimin tradicional të maqedonasve, shqiptarëve, turqve, romëve, serbëve, boshnjakëve dhe vllahëve (siç është Turlitava- një ushqim tradicional ballkanik).

Në vitin 2014, KHM siguroi financimin e dy programeve që kanë të bëjnë me edukimin joformal të të rinjve - Shkolla verore dhe dimërore për të rinj mbi të drejtat e njeriut. Shkolla verore është mbaj-

tur në Shkup dhe ka zgjatur një javë si një bashkëpunim pilot midis KHM dhe Institutit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut për paqe, një OJQ nga rajoni i Normandisë, Francë. Fokusi i veçantë i Shkollës verore ishte mbi krimet nga urrejtja etnike dhe fetare midis të rinjve në shteti dhe Francë. Ligjërata të përbashkëta nga ekspertë nga shteti dhe Franca u ofruan 20 pjesëtarëve (15 nga shteti dhe 5 nga Franca) të moshës midis 19 dhe 24 vjeçare. Shkolla dimërore ishte e mbështetur nga Ambasada e Gjermanisë në shteti dhe u mbajt në qytetin e Velesit për 25 të rinj të moshës midis 16 dhe 19 vjeçare nga shteti. Ajo përfshinte tema të ndryshme mbi të drejtat e njeriut, me një ditë të tërë kushtuar gjuhës së urrejtjes dhe krimit nga urrejtja. KHM kishte rezervuar 5 vende për nxënësit e shkollave të mesme të cilët mësojnë në shkollat në të cilat janë shënuar pjesa më e madhe e krimeve nga urrejtja në vitin 2013 dhe 2014. 3 nga 5 vendet ishin të plotësuar nga kandidatë nga shkollat e tilla si vijojnë: Pançe Karagjov, Marie Sklodovska-Curie dhe Arseni Jovkov.

Përveç kësaj, KHM ka hapur një faqe për vetëdijesim për krimet nga urrejtja në Facebook (<http://goo.gl/8yY5Lk>), një faqe në Twitter (<https://twitter.com/HateCrimesMK>) dhe ka futur një seksion të veçantë mbi krimet nga urrejtja në raportet e saja mujore mbi situatën me të drejtat e njeriut në Maqedoni të cilat janë të shpërndara tek institucionet shtetërore, mediat, OJQ-të, organizatat ndërkombëtare dhe ambasadat e huaja në vend.

### 4.5 Monitorimi i krimeve nga urrejtja dhe incidenteve nga urrejtja nëpër ngjarjet sportive

Ekipi i projektit monitoroi 4 ndeshje të futbollit të ligës së parë kombëtare të futbollit dhe kupës kombëtare të futbollit: Shkëndija kundër Vardarit - 1/8 finale e garës për kupë (24 shtator, 2014); Teteks kundër Renovës (05 tetor, 2014); Shkëndija kundër Vardarit (19 tetor, 2014); Vardari kundër Shkëndijës - pjesa e dytë e 1/8 finales për kupë (22 tetor 2014).. Gjatë të gjitha ndeshjeve të vështruar, tifozët e mysafirëve ishin të ndaluar nga pjesëmarrja në ndeshje. Një numër i rritur i nëpunësve policor ishte i dukshëm në autostradën Shkup-Tetovë, në pikat hyrëse në qytetet si dhe në afërsi dhe brenda stadiumeve të futbollit. Megjithatë nuk është regjistruar asnjë krim nga urrejtja gjatë ndeshjeve të përcjellura, në mënyrë të vazhdueshme kishte brohoritje me gjuhë të urrejtjes nga tifozët lokal gjatë të gjitha ndeshjeve.

Brohoritjet siç janë “Mrtov shiptar, dobar shiptar!” (Shqiptari i vdekur, shiptar i mirë!); Kaur i vdekur, kaur i mirë! (Krishter i vdekur, krishter i mirë!); Ubi, ubi, ubi Srbina! (Vraje, vraje serbin!); Za Shiptari gasna komora! (Dhomë gazi për shqiptarët!); Shqipri etnike, gjithashtu “Shqipëri e madhe”; Jebem Vardar, jebem Kaur, jebem Komiti! (Qije Vardarin, qiji krishterët, qiji komitat); I toj e stoka i toj e Shiptar! (Ai është bagëti, ai është shiptar!); Abre Makedonche, borba te cheka, borba za sloboda, protiv kletite Shiptari! (Hej o maqedon, po të pret lufta, lufta për liri, kundër shqiptarëve të mallkuar!); Abre Makedonche, borba te cheka, borba za sloboda, protiv kletite Shiptari! (Maqedonia është për maqedonasit, kështu ka qenë gjithmonë dhe do të jetë kështu, do t'i shkatërrojmë të gjithë armiq të tonë!); Shiptarski kurvi! (Bushtra shqiptare!); Çista, çista, çista Makedonija! (Maqedoni e pastër, e pastër, e pastër!) mund të dëgjoheshin në pothuajse të gjitha ndeshjet midis ekipeve ku kishte bashkësi të ndryshme etnike në shteti.

Pas ndeshjes së 1/8 të finales së kupës kombëtare midis KF Shkëndija dhe KF Vardar, portieri i Vardarit është goditur nga tifozët e KF Shkëndija (“Ballistët”), me një gurë të vogël në kokë. Lojtarët përpiqeshin të qetësojnë tifozët dhe i ndihmuan ekipit mjekësor për të mjekuar portierin. Rrjedhim-

6) Në dispozicion në: <https://www.youtube.com/watch?v=MtXzXQImFQk>

isht, klubi u dënua me 2.500 euro në pajtim me nenet 36, 38 dhe 51 të Rregullores disiplinuese të Federatës futbolistike të Maqedonisë, në baza të thirrjeve të sloganeve ofenduese, përdorimit të fishekzjarrëve dhe hedhjes së objekteve të rënda gjatë ndeshjes.

## 5. KONKLUZAT

- Shteti nuk grumbullon të dhëna mbi krimet nga urrejtja megjithëse ka përgatitje fillestare nga ana e gjyqësorit të fillohet me regjistrimin e këtij lloji të krimeve, nuk është e sigurt se a do të ketë të dhëna zyrtare gjithëpërfshirëse dhe krahasuese në një të ardhme të afërt.
- Viktimat nuk dëshirojnë që të përmenden emrat e tyre, as publikisht e as para institucioneve shtetërore, duke u frikësuar nga pasojat të cilat çojnë drejt mos raportimit të mjaftueshëm dhe mungesës së besimit të popullit në sistem.
- Janë bërë shumë pak përpjekje për masat parandaluese duke përfshirë këtu edhe edukimin mbi të drejtat e njeriut dhe ngritjen e vetëdijes midis popullsisë.
- Krimet e motivuara nga paragjykimet nuk janë të raportuara apo hetuara si duhet nga ana e policisë.
- Praktikuesit relevant nuk marrin trajnime përkatëse në lidhje me identifikimin dhe reagimin e incidenteve nga urrejtja.
- Duke mos trajtuar fenomenin e krimit nga urrejtja si një çështje të ndarë, Shteti nuk ofron mbrojtje të veçantë apo mbështetje për viktimat.
- Anëtarët më të prekur të shoqërisë janë rinia, por gjithashtu edhe anëtarët e bashkësisë së LGBTI, pjesërisht si pasojë e asaj se fakti se orientimi seksual dhe identiteti gjinor nuk janë të njohura si baza mbi të cilat mund të kryhen krimet nga urrejtja.
- Krimet nga urrejtja zakonisht ndodhin në vende publike. Një numër i madh i incidenteve ndodhin në autobusë, afër stacioneve të autobusit, në oborret shkollore dhe afërsi dhe kundrejt degëve lokale të partive politike.
- Shumica e krimeve nga urrejtja janë të kryera nga hakmarrja apo pasoja pas një incidenti paraprak midis rinisë maqedonase dhe shqiptare.
- Një numër i madh i incidenteve ndodhin gjatë apo pas orëve shkollore.
- Vetëm 2 incidente janë regjistruar në shteti lindore. Kjo mund të jetë për shkak të përbërjes etnike të vendit, por gjithashtu edhe si rezultat i mos raportimit të mjaftueshëm dhe nivelit të ultë të vetëdijes tek populli për krimet nga urrejtja dhe motivet nga paragjykimet.

## 6. REKOMANDIME

Gjatë takimit të Këshillit të UE-së për drejtësi dhe çështjet vendore, të mbajtur në Bruksel më 5-6 dhjetor, 2013, Këshilli botoi Konkluzat e saja në lidhje me luftimin e krimeve nga urrejtja në UE. Si shtet që aspiron të bashkëngjitet në UE, shteti duhet të përcjell rekomandimet të cilat janë të përmbytura në Konkluzat të cilat janë gjerësisht në vijë me rekomandimet e përmbytura në Vendimin e Këshillit ministror të OSBE-së Nr. 9/09: Luftimi i krimeve nga urrejtja, ndërsa vështrimi i KHM-së:

1. Të konsiderohet përvoja e vendeve anëtare të UE-së në zgjerimin brenda legjislacionit të tyre penal, shtrirjen e shkeljeve të dënueshme të krimeve nga urrejtja apo motiveve të tjera nga paragjykimi;
2. Të sigurohet hetim i shpejtë dhe efikas dhe ndjekje e krimeve nga urrejtja duke u siguruar se motivet nga paragjykimi të merren parasysh edhe gjatë procedurës penale;
3. Të merren masa të përshtatshme që të lehtësohet raportimi i krimeve nga urrejtja nga ana e viktimave dhe sa të jetë e mundur edhe e shoqatave të cilat i përkrahin ata, duke përfshirë edhe masa për të krijuar besimin tek policia dhe tek institucionet e tjera shtetërore;
4. Të grumbullohen dhe botohen të dhëna gjithëpërfshirëse dhe krahasuese në lidhje me krimet nga urrejtja, sa më larg që të jetë e mundur, duke përfshirë edhe numrin e incidenteve të tilla të raportuara nga publiku dhe të regjistruara nga autoritetet policore; numrin e dënimeve; motivet paragjyquese pas këtyre krimeve; dhe dënimet që u janë shqiptuar autorëve të krimit;
5. Të sigurohen se viktimat e krimeve nga urrejtja të ndihmohen, përkrahen dhe mbrohen;
6. Të promovohen trajnime për praktikuesit relevant të cilët vijnë në kontakt me viktimat e krimeve nga urrejtja, duke u mundësuar që të ndihmojnë këto viktime në mënyrë efektive; dhe
7. Rritjen e masave parandaluese, ndër të tjera, duke u përkujtuar në edukimin mbi të drejtat e njeriut, programin mësimor të historisë dhe trajnim përkatës, duke ndërmarrë hapa për të edukuar popullsinë për vlerat e shumëllojshmërisë dhe përfshirjes dhe me qëllim që të gjithë sektorët e shoqërisë të kenë një rol në luftimin e mostolerimit të tillë.

## INCIDENTET NGA KRIMET E URREJTJES NË 2014

### 1. Vandalizohen varrezat krishtere në kishën e fshatit Vollkovë, të Shkupit (i verifikuar)

**Çka ka ndodhur:** kryerës të panjohur kanë hyrë në kishën Shën.Anastasij dhe Shën. Petka, kanë përdhosur disa gurrë të varrezave dhe kanë dëmtuar shenjat që të drejtojnë kisha në fshat.

**Data, koha dhe lokacioni i incidentit:** 12 janar, incidenti është raportuar ora 08:20 min. Lokacioni i incidentit është kisha Shën.Anastasij dhe Shën. Petka, në Vollkovë.

**Burimi i informacionit:** Mediumi nacional Press24.

**Viktima(t) e përfshirë:** Përveç dëmit material, nuk ka pasur viktima të drejtëpërdrejta nga ky incident.

**Lloji i krimit(ve):** Vandalizimi i varrezave, neni. 400 nga Kodi Penal (KPRM). Nxitja e urrejtjes, përçarjes dhe jotolerancës në baza entike, racore dhe religjioze apo diskriminuese neni. 319.

**Kryerësi(t):** i/e panjohur.

**Përshkrimi i shkurtër i incidentit me treguesit e anshmërisë:** Në këtë incident, motivi i anshmërisë është përkatësia religjioze dhe bindjet fetare, ndërsa treguesit e anshmërisë është:

1. Lokacioni i incidentit – Kisha ortodokse krishtere.

**Statusi i rastit:** Incidenti është raportuar tek autoritetet lokale.

**Reagimi i autoriteteve lokale:** Hetimet janë në rrjedhë.

**Ndikimi në viktim(-at) dhe komunitet:** Incidenti është një nga incidentet e më shumta që kanë ndodhur gjatë vitit, i cili e vendos në pikëpyetje bashkëjetesën etnike në mes dy komuniteteve më të mëdha në vend.

### 2. Thyerja e pllakës komemorative të Mara Bunevas (i verifikuar)

**Çka ka ndodhur:** Pllaka komemorative e Mara Bunevas, e krijuar nga organizata Bullgare, është thyer në ditën e prezantimit publik.

**Data, koha dhe lokacioni i incidentit:** 13 janar, në një bankë afër lumit Vardar në qendrën e Shkupit.

**Burimi i informacionit:** Mediumi regional Centarnews.

**Viktima(t) e përfshirë:** Përveç dëmit material, nuk ka pasur viktima të drejtëpërdrejta nga ky incident.

**Lloji i krimit(ve):** Dëmtimi i pronës së huaj neni. 243 KPRM, nxitja e urrejtjes, përçarjes dhe jotolerancës në baza entike, racore dhe religjioze apo diskriminuese neni. 319.

**Kryerësi(t):** i/e panjohur.

**Përshkrimi i shkurtër i incidentit me treguesit e anshmërisë:** në këtë incident, motivi i anshmërisë është përkatësia etnike, kombëtare ose gjuhësore, ndërsa treguesit e anshmërisë janë:

1. Perceptimet e viktimës – Fakti që viktima indirekte e krimit është organizata Bullgare e angazhuar në aktivitete për promovim të grupit para se të ndodh incidenti.

2. Strukturat e incidenteve të mëhershme - Ky incident ndodh dy vite rresht.

**Statusi i rastit:** Incidenti është raportuar tek autoritetet lokale.

**Reagimi i autoriteteve lokale:** Policia ka reaguar urgjentisht duke bërë hetime në vendin e ngjarjes. Hetimet janë në rrjedhë.

**Ndikimi në viktim(-at) dhe komunitet:** Ky lloj incidentesh sjell në pikëpyetje situatën e përgjithshme politike në vend si dhe bashkëjetesën në mes maqedonasve në njërin anë, dhe bullgarëve në anën tjetër.

### 3. Demolohet automjeti i Partisë Liberal Demokratike (i pa verifikuar)

**Çka ka ndodhur:** Kryerës i/e panjohur kanë thyer xhamin dhe e kanë dëmtuar veturën me mbishkrimin e partisë.

**Data, koha dhe lokacioni i incidentit:** Në orët e herëshme të 14 janarit. Lokacioni i paspecifikuar.

**Burimi i informacionit:** Ueb portali daily.mk.

**Viktima(t) e përfshirë:** Përveç dëmit material, nuk ka pasur viktima të drejtëpërdrejta nga ky incident.

**Lloji i krimit(ve):** Dëmtimi i pronës së huaj neni. 243 KPRM.

**Kryerësi(t):** i/e panjohur.

**Përshkrimi i shkurtër i incidentit me treguesit e anshmërisë:** motivi i anshmërisë është përkatësia partiake dhe bindjet politike, ndërsa treguesit e anshmërisë është:

1. Simboli i caktuar, përfshinë një automjet me një simbol që ka rendësi politike – llogoja e partisë.

**Statusi i rastit:** i/e panjohur.

**Reagimi i autoriteteve lokale:** i/e panjohur.

**Ndikimi në viktim(-at) dhe komunitet:** Ky lloj i incidenteve sjell në pikëpyetje stabilitetin e përgjithshëm politikë në vend.

### 4. Dëmtohet zyra e degës së Lidhjes Social Demokratike të Maqedonisë (LSDM) në Strumicë (i verifikuar)

**Çka ka ndodhur:** Kryerësi i/e panjohur ka dëmtuar zyrën e degës së pnenies, duke thyer dritaret e përparme.

**Data, koha dhe lokacioni i incidentit:** 18 janar, ora 03:00 pas mesnate, në Strumicë.

**Burimi i informacionit:** Mediumi regional Fama.

**Viktima(t) e përfshirë:** Përveç dëmit material, nuk ka pasur viktima të drejtëpërdrejta nga ky incident.

**Lloji i krimit(ve):** Dëmtimi i pronës huaj neni. 243 KPRM.

**Kryerësi(t):** Dy persona. Njëri është i njohur për pronarin e lokalit dhe identiteti i tij i është raportuar autoriteteve.

**Përshkrimi i shkurtër i incidentit me treguesit e anshmërisë:** në këtë incident, motivi i anshmërisë është përkatësia religjioze dhe bindjet fetare, ndërsa treguesit e anshmërisë janë:

1. Caku /perceptimi i dëshmitarit – Si cak në këtë incident paraqitet zyra e degës së partisë më të madhe opozitare, ndërsa dëshmitari e percepton incidentin si akt frikësimi.

2. Frekuenca e incidentit – Ky incident është i ngjashëm sikurse incidenti i ndodhur disa javë më herët.

**Statusi i rastit:** nën hetim.

**Reagimi i autoriteteve lokale:** Policia ka reaguar menjëherë dhe kanë hetuar skenën. Sipas pronarit të lokalit, policia nuk ka siguruar objektin në të cilin ndodhi dëmtimi, edhe pse pronari i lokalit bëni apel. Hetimi vazhdon.

**Ndikimi në viktim(-at) dhe komunitet:** Ky lloj i incidenteve sjell në pikëpyetje stabilitetin e përgjithshëm politikë në vend, për faktin se Strumica është një qytet në të cilin partia më e madhe opozitare në shteti ka shumicën në Këshillin komunal.

### 5. Përleshje me gypa metali në shkollën e mesme Zdravko Cvetkovski në Shkup (i pa verifikuar)

**Çka ka ndodhur:** Në oborrin e shkollës, një nxënës ka sulmuar një nxenes tjetër, me pastaj viktima tentoi të hakmerret me një gyp metalik. Ai u ndërpre në qëllimin e tij nga ana e sigurimit të shkollës.

**Data, koha dhe lokacioni i incidentit:** 21 janar, ora 13:30 në oborrin e shkollës së mesme Zdravko Cvetkovski në Shkup.

**Burimi i informacionit:** Mediumi regional Sky.

**Viktima(t) e përfshirë:** Një nxënës i shkollës së mesme.

**Lloji i krimit(ve):** Lëndim truporë, neni. 130 KPRM

**Kryerësi(t):** një nxënës i shkollës së mesme.

**Përshkrimi i shkurtyr i incidentit me treguesit e anshmërisë:** në këtë incident, motivi i anshmërisë është përkatësia etnike, kombëtare apo gjuhësore, ndërsa treguesit e anshmërisë janë:

1. *Dallimi i supozuar i përkatësisë etnike në mes të kryerësit dhe viktimës* – Për shkak të përbërjes së përzier etnike të nxënësve të kësaj shkolle, përkatësia etnike e kryerësit dhe viktimës mund të jetë e ndryshme.

2. *Natyra e dhunës* – Incidenti ka ndodhur publikisht, në presence të nxënësve tjerë.

3. *Mungesa e motiveve tjera.*

**Statusi i rastit:** l/e panjohur.

**Reagimi i autoriteteve lokale:** l/e panjohur.

**Ndikimi në viktim(-at) dhe komunitet:** Ky lloj incidentesh sjell në pikëpyetje situatën e përgjithshme politike në vend si dhe bashkëjetesën në mes maqedonasve në njërin anë, dhe shqiptarëve në anën tjetër, si dhe sigurinë e përgjithshme të nxënësve në ambientin e shkollës.

## 6. Parandalohet përleshja ndëretnike në komunën Gjorçe Petrov në Shkup dhe në fshatin Krushopek (i verifikuar)

**Çka ka ndodhur:** Forcat policore duhej të intervenonin që të parandalohet përleshja në fshatin Krushopek afër Shkupit pas një takimi zyrtarë në mes përkrasësve të dy klubeve futbolistike lokale. Një grup i të miturve maqedonas kanë dëmtuar automjete, kanë gjuajtur shtëpi me gurrë dhe kanë ofenduar njerëz që kanë kaluar aty pranë. Sipas burimeve policore (dhe publikimeve në media), këtij akti i ka paraprirë një tentative për të hyrë në Gjorçe Petrov një grupi prej 30 shqiptarëve nga fshati Krushopek. Policia ka intervenuar në kohe dhe ka parandaluar një incident edhe më të gjërë.

**Data, koha dhe lokacioni i incidentit:** 31 janar, në fshatin Krushopek, Shkup.

**Burimi i informacionit:** Mediumi regjional Almakos (alb.) dhe Telegraf (mk.).

**Viktima(t) e përfshirë:** Përveç demit material, nuk ka pasur viktimë me dëmtime trupore nga ky incident. Njerëzit nga komuniteti lokal kanë qenë të fyer.

**Lloji i krimit(ve):** Dëmtimi i pronës së huaj neni. 243 KPRM, dhunë neni. 386, rrezikimi i sigurisë neni. 144, dhe nxitje të urrejtjes, përçarjes dhe intolerancës në baza nacionale, racore, religjioze dhe baza tjera neni. 319.

**Kryerësi(t):** një grupë e njëzetë të miturve nga Shkupi (Maqedonas etnik).

**Përshkrimi i shkurtyr i incidentit me treguesit e anshmërisë:** Në këtë incident, motivi i anshmërisë është përkatësia etnike, gjuhësore dhe nacionale, ndërsa idikatorët e anshmërisë janë:

1. *Perceptimi i viktimës* – Fakti që viktimat e krimit më pas u takuan bashkë, me sa duket të hakmerren tregon perceptimin e viktimës se aktet kriminale janë të motivuara nga paragjykim, si dhe fakti që grupi kishte lidhje me viktimën (përkrasësit e klubit futbolistik) i cili ishte edhe promotorë i kësaj kulture para incidentit.

2. *Dallimi në përkatësinë etike të kryerësit të veprës dhe viktimës*

3. *Lokacioni dhe koha* – Incidenti ka ndodhur pas një ngjarrje të organizuar nga përkrasësit e klubeve futbolistike maqedonase dhe shqiptare, në një fshat i cili banohet kryesisht nga komuniteti shqiptar në shteti.

4. *Natyra e dhunës* - Incidenti ndodhi në publik.

**Statusi i rastit:** Policia arrestoi autorët e krimit.

**Reagimi i autoriteteve lokale:** Policia reagoi menjëherë dhe parandaloi eskalimin e dhunës. Megjithatë, vetëm katër nga kryerësit e veprës u dënuan me veprën penale – dhunë, dhe asnjë dënim nuk është shqiptuar për veprat e nxitjes së urrejtjes, mosmarrëveshjes dhe intolerancës në baza etnike, religjioze apo diskriminimit në baza tjera, rrezikim të sigurisë dhe dëmtimit të pronës së huaj.

**Ndikimi në viktim(-at) dhe komunitet:** Këto lloje incidentesh sjellin në pikëpyetje situatën e përgjithshme politike në vend si dhe bashkëjetesën në mes maqedonasve etnik, nga njëra anë dhe shqiptarëve etnik si dy grupe të komuniteteve më të mëdha në vend.

## 7. Djem nga Studeniçani rrahin një të ri para shkollës së mesme Marija Kiri Sklodovska në Shkup (i verifikuar)

**Çka ka ndodhur:** Dy djem të moshës 22 vjeçare kanë sulmuar fizikisht një djalë me moshë më të re i një përkatësie tjetër. Pas sulmit ata u përpoqën të largohen me makinën e tyre në drejtim të fshatit Studeniçan, me çrast devijuan rrugën dhe përfunduan në një kanal.

**Data, koha dhe lokacioni i incidentit:** 7 shkurt, para shkollës së mesme Marija Kiri Sklodovska në Shkup.

**Burimi i informacionit:** Media regjionale/lokale Press24, gazeta Veçer.

**Viktima(t) e përfshirë:** Një i mitur i përkatësisë etnike maqedonase.

**Lloji i krimit(ve):** Lëndim truporë, neni.130 KPRM

**Kryerësi(t):** Dy shqiptarë etnik.

**Përshkrimi i shkurtyr i incidentit me treguesit e anshmërisë:** Në këtë incident, motivi anshmërisë është përkatësia etnike, gjuhësore ose shtetësia, ndërsa treguesit e anshmërisë janë:

1. *Dallimi në baza etnike në mes të kryerësit dhe viktimës.*

2. *Mungesa e motiveve tjera.*

**Statusi i rastit:** Akuza për kundërvajtje është ngritur.

**Reagimi i autoriteteve lokale:** Policia deklaroi nëpërmjet mediave se djemtë do të ndiqet për kundërvajtjet (ndoshta rrezikim të sigurisë në trafik), por jo për një krim.

**Ndikimi në viktim(-at) dhe komunitet:** Ky lloj i incidenteve sjell në pikëpyetje gjendjen e përgjithshme politike në vend dhe bashkëjetesën mes maqedonasve etnikë, në njërin anë dhe shqiptarëve etnikë, si dy bashkësi etnike më të mëdha në shoqëri.

## 8. Arrestohen 21 anëtarë të grupit të përkrasësve sportiv Komiti (i verifikuar)

**Çka ka ndodhur:** Një grup prej afërsisht 40 anëtarësh nga grupi përkrasës Komiti, para ndeshjes futbolistike në të cilën morrën pjesë, kanë fyer dhe rrahur disa të mitur në autobusin numër 2. Prej atje, ata kanë shkuar në sallën sportive Boris Trajkovski në Shkup, ku ata kanë prishur qetësinë dhe rendin publik, janë përleshur në mes veti, dhe kanë gjuajtur me gjësende nga lojtarët në fushën e sportit. Kur policia ka intervenuar, përkrasësit kanë sulmuar zyrtarët, dhe njëri nga ata, e ka gjuajtur me një gjësend të rëndë me çrast ka lënduar një zyrtarë policorë.

**Data, koha dhe lokacioni i incidentit:** 9 shkurt, në Shkup, në autobusin numër 2 të transportit publik dhe në sallën sportive Boris Trajkovski në Shkup.

**Burimi i informacionit:** Mediumi i shypur nacional Dnevnik.

**Viktima(t) e përfshirë:** Disa(numri i saktëi panjohur) të mitur nga nacionaliteti shqiptar dhe një zyrtarë policor.

**Lloji i krimit(ve):** Lëndim truporë neni.130 KPRM, dëmtimi i pronës së huaj neni.243, dhunë neni. 386, rrezikimi i sigurisë neni.144, sulmi i zyrtarit policor derisa ai kryen punë në lidhje me sigurinë neni. 383, nxitja e urrejtjes, përçarjes dhe intolerancës racore, nacionale, fetare ose diskriminim në baza tjera neni. 319.

**Kryerësi(t):** 40 anëtarësh nga grupi përkrasës Komiti, maqedonas etnik.

**Përshkrimi i shkurtyr i incidentit me treguesit e anshmërisë:** Në këtë incident, motivi anshmërisë është përkatësia etnike, kombëtare apo gjuhësore, dhe treguesit e anshmërisë janë:

1. *Dallimi në baza etnike e kryerësit dhe viktimës* – Autobusi numër 2 në rrugën e tij përfshinë Sarajin, një fshat i madh i banuar kryesisht nga shqiptarët, me çrast është logjike të supozohet se pasagjerët e këtij autobusi të jenë të përkatësisë së njejtë etnike, dhe rrjedhimisht të jenë cak i grupit Komiti.

2. *Lokacioni dhe koha* – Incidenti ka ndodhur në autobusin numër 2 të transportit publik, linja e të cilit kalon në një fshat që ka përbërje dominante etnike shqiptare. Ai u pasua nga një ndeshje sportive të cilën e ndoqën kryerësit, dhe vazhduan të kryejnë krimet.

3. *Modeli / Frekuenca e incidenteve të mëparshme* – Përkrahësit e klubit, në një numër rastesh, kanë manifestuar haptazi dhunën ndaj komunitetit shqiptar.

4. *Natyra e dhunës* – Incidenti ka ndodhur publikisht.

**Statusi i rastit:** Akuzat janë ngritur nga policia.

**Reagimi i autoriteteve lokale:** Policia deklaroi nëpërmjet mediave se ajo ka ngritur akuza kundër shtatë prej autorëve të krimit, ndërsa 14 tjerë janë dënuar me gjobë. Ajo nuk specifikon bazën mbi të cilat ata ishin akuzuar apo gjobitur.

**Ndikimi në viktim(-at) dhe komunitet:** Ky lloj i incidenteve sjell në pikëpyetje gjendjen e përgjithshme politike në vend dhe bashkëjetesën mes maqedonasve dhe shqiptarëve etnikë, si dy bashkësive etnike më të mëdha në shoqëri. Ajo gjithashtu rrezikon ndjenjën e publikut për sigurinë gjatë manifestimeve sportive.

## 9. Një dhjetëvjeçar i lënduar rëndë gjatë një zënke afër qendrës tregtare Vero në Shkup (i pa verifikuar)

**Çka ka ndodhur:** Një fëmijë pësoi lëndime të rënda dhe tre të tjerë pësuan lëndime më të lehta pas një zënke të egër në afërsi të qendrës tregtare Vero në Shkup. Dy grupe kanë marrë pjesë në zënkën, një nga fshati Katllanovë (e banuar kryesisht me maqedonas etnikë), dhe tjetri nga fshati Batincë (i banuar kryesisht nga popullata islame, shumica e të cilave janë shqiptarë).

**Data, koha dhe lokacioni i incidentit:** 12 shkurt në afërsi të qendrës tregtare Vero në Shkup.

**Burimi i informacionit:** Mediumi nacional Vest.

**Viktima(t) e përfshirë:** Një i mitur, maqedonas etnik dhe tri djem të rinj nga fshati Batincë

**Lloji i krimit(ve):** Lëndim i rëndë truporë, neni.131 KPRM, pjesëmarrje në përleshje, neni.132, nxitja e urrejtjes, përçarjes dhe intolerancës racore, nacionale, fetare ose diskriminim në baza tjera, neni.319.

**Kryerësi(t):** Nëntë të rinj, pesë nga Batinca, dhe katër (përfshi edhe një të mitur) nga Katlanova.

**Përshkrimi i shkurtër i incidentit me treguesit e anshmërisë:** Në këtë incident, motivi anshmërisë është përkatësia etnike, shtetësia apo gjuha, dhe treguesit e anshmërisë janë:

1. *Dallimi e përkatësisë etnike në mes kryerësit dhe viktimës* – Konsiderohet struktura dominante etnike e fshatit nga i cili vijnë.

2. *Natyra e dhunës* – Ky incident është kryer në publikë.

3. *Mungesa e motiveve tjera.*

**Statusi i rastit:** I/e panjohur.

**Reagimi i autoriteteve lokale:** Policia deklaroi nëpërmjet mediave që ata do të ndërmarrin masat e duhura, por në momentin e shkrimit të këtij raporti, policia nuk i është përgjigjur kërkesës për informacion me karakter publik që është dërguar nga ana e Komitetit në lidhje me këtë incident.

**Ndikimi në viktim(-at) dhe komunitet:** Ky lloj i incidenteve sjell në pikëpyetje gjendjen e përgjithshme politike në vend dhe bashkëjetesën mes maqedonasve dhe shqiptarëve etnikë në anën tjetër, si dy bashkësi etnike më të mëdha në vend.

## 10. Gjujtje me gurrë në zyrën e degës së Opcionit Qytetar të Maqedonisë (GROM) në Komunën Butel në Shkup (i verifikuar)

**Çka ka ndodhur:** Gjatë orëve të natës, kryerës të panjohur kanë gjuajtur me gurrë në zyrën e degës së Opcionit Qytetar të Maqedonisë (GROM) në Komunën Butel në Shkup.

**Data, koha dhe lokacioni i incidentit:** 14 shkurt, ora 03:30, zyra e degës së Opcionit Qytetar të Maqedonisë (GROM) në Komunën Butel në Shkup.

**Burimi i informacionit:** Media elektronike nacionale mkd.mk.

**Viktima(t) e përfshirë:** Përveç dëmit material, nuk ka pasur viktimë direkte nga ky incident.

**Lloji i krimit(ve):** Dëmtimi i pronës së huaj, neni. 243 KPRM.

**Kryerësi(t):** I/e panjohur.

**Përshkrimi i shkurtër i incidentit me treguesit e anshmërisë:** Në këtë incident, motivi i anshmërisë është anëtarësia partiake dhe bindjet politike, ndërsa treguesi i anshmërisë është:

1. *Caku / perceptimi i dëshmitarit - objektiv është zyra e degës së një pnenie opozitare, mund të perceptohet si akt të frikësimit.*

**Statusi i rastit:** Nën hetim.

**Reagimi i autoriteteve lokale:** Policia deklaroi nëpërmjet mediave që ata janë duke punuar për sqarimin e rastit, por Komiteti nuk ka asnjë informacion për akuzate mundshme.

**Ndikimi në viktim(-at) dhe komunitet:** Ky lloj i incidenteve të vë në pikëpyetje stabilitetin e përgjithshëm politik në vend.

## 11. Rrahje masive në qendër të Shkupit (i pa verifikuar)

**Çka ka ndodhur:** Dy grupe të rinjës janë përleshur në bulevardin Kuzman Josifovski Pitu në qendër të Shkupit. Kryerësit janë nga fshatrat Elovë, Drazilov dhe Pagarush.

**Data, koha dhe lokacioni i incidentit:** 14 shkurt, në bulevardin Kuzman Josifovski Pitu në qendër të Shkupit.

**Burimi i informacionit:** Mediumi nacional Makfax.

**Viktima(t) e përfshirë:** Një nga të rinjtë e përfshirë në rrahjen është goditur me thikë.

**Lloji i krimit(ve):** Lëndim i rëndë truporë, neni.131 KPRM, pjesëmarrje në përleshje, neni.132 KPRM.

**Kryerësi(t):** Tetë të rinj, supozohet nga grupet e ndryshme etnike.

**Përshkrimi i shkurtër i incidentit me treguesit e anshmërisë:** Në këtë incident, motivi anshmërisë është përkatësia etnike, shtetësia apo gjuha, dhe treguesit e anshmërisë janë:

1. *Dallimi i supozuar etnik në mes kryerësit dhe viktimës* – kur kemi parasysh përbërjen e përzier etnike në fshatrat e përmendura, përkatësia e viktimës dhe kryerësit të vepres mund të dallojnë.

2. *Mungesa e motiveve tjera.*

**Statusi i rastit:** Akuzat e shkeljes janë ngritur.

**Reagimi i autoriteteve lokale:** Ministria e Punëve të Brendshme duke u përgjigjur në Kërkesën për dhënie e informacionit të karakterit publik dërguar nga ana e Komitetit, informoi se për tetë persona të përfshirë në përleshje, është ngritur akuza për veprën “përleshje”, në pajtueshmëri me Ligjin për kundërvajtje ndaj rendit dhe qetësisë publike.

**Ndikimi në viktim(-at) dhe komunitet:** Ky lloj i incidenteve sjell në pikëpyetje gjendjen e përgjithshme politike në vend dhe bashkëjetesën mes maqedonasve dhe shqiptarëve etnikë, si dy bashkësi etnike më të mëdha në vend.

## 12. Një i ri nga Tetova goditet me thikë në gjoks (i pa verifikuar)

**Çka ka ndodhur:** Një i ri nga Tetova u godit me thikë në gjoks gjatë një përleshje, ndërsa një tjetër ka pësuar lëndime trupore.

**Data, koha dhe lokacioni i incidentit:** 14 shkurt, në Tetovë.

**Burimi i informacionit:** Mediumi nacional elektronik mkd.mk.

**Viktima(t) e përfshirë:** një i djalë i moshës tetëmbëdhjetë vjeçare nga fshati Çellopek i cili u goditë me thikë dhe u transferua në spitalin e Shkupit, dhe një i ri tjetër.

**Lloji i krimit(ve):** Lëndim i rëndë truporë, neni. 131 KPRM, pjesëmarrje në përleshje, neni. 132.

**Kryerësi(t):** Dy të rinj me përkatësi etnike të panjohur.

**Përshkrimi i shkurtër i incidentit me treguesit e anshmërisë:** Në këtë incident, motivi i anshmërisë është përkatësia etnike, kombëtare ose gjuhësore, ndërsa tregues të anshmërisë janë:

1. *Dallimi i supozuar etnik në mes kryesit të veprës dhe viktimës* - Për shkak të përbërjes së përzier etnike të popullatës në fshatin dhe qytetin e përmendur, përkatësia etnike e viktimës mund të ndryshojë nga ai i autorit të krimit.

**Statusi i rastit:** Policia nëpërmjet mediave deklaroi që ata do të ndërmarrin masat e duhura për të sqaruar rastin, por në momentin e shkrimit të këtij raporti, policia nuk i është përgjigjur Kërkesës për informacion me karakter publik që u është dërguar nga Komiteti në lidhje me këtë incident.

**Reagimi i autoriteteve lokale:** Policia nëpërmjet mediave deklaroi që ata do të ndërmarrin masat e duhura për të sqaruar rastin, mirëpo Komiteti nuk ka informacion në lidhje me akuzat e mundëshme.

**Ndikimi në viktim(-at) dhe komunitet:** Ky lloj i incidenteve sjell në pikëpyetje gjendjen e përgjithshme politike në vend dhe bashkëjetesën mes maqedonasve, në njërën anë dhe shqiptarëve në anën tjetër si dy bashkësive më të mëdha etnike në vend.

### 13. Një vajzë e re e rrahur nga një djalë në një autobus publik (i pa verifikuar)

**Çka ka ndodhur:** Një djalë 25 vjeçarë ka sulmuar një vajzë 19 vjeçare në autobusin e transportit publik me numër 62 në Shkup.

**Data, koha dhe lokacioni i incidentit:** 14 shkurt, ora 12:00 në një autobus publik me numër. 62, derisa vozitej në bulevardin Kuzman Josifufski Pitu në Shkup.

**Burimi i informacionit:** Mediumi i shkruar nacional Nova Makedonija.

**Viktima(t) e përfshirë:** Një vajzë nëntëmbëdhjet vjeçare me përkatësi etnike të panjohur.

**Lloji i krimit(ve):** Dhunë, neni. 386 KPRM, lëndim truporë, neni.130 KPRM.

**Kryerësi(t):** një djalë njëzetvjeçarë me përkatësi etnike të panjohur.

**Përshkrimi i shkurtër i incidentit me treguesit e anshmërisë:** Në këtë incident, motivi i anshmërisë është përkatësia etnike, nacionale ose gjuhësore, ndërsa treguesit e anshmërisë janë:

1. *Dallimi i supozuar etnik në mes kryesit të veprës dhe viktimës* - Për shkak të përbërjes etnike të populates në fshatin e Ognjancit (fshat në të cilin autobusi No.62 udhëton), përkatësia e viktimës mund të dallojë nga ajo e kryerësit.

2. *Natyra e dhunës* – Incidenti ka ndodhur publikisht.

3. *Mungesa e motiveve tjera.*

**Statusi i rastit:** Nën hetim.

**Reagimi i autoriteteve lokale:** Autoritetet deklaruan nëpërmjet mediave se ata po marrin masa për sqarimin e rastit.

**Ndikimi në viktim(-at) dhe komunitet:** Ky lloj i incidenteve sjell në pikëpyetje gjendjen e përgjithshme politike në vend dhe bashkëjetesën mes komuniteteve të ndryshme etnike në shoqëri.

### 14. Të miturit nga fshati Nikishtanë kanë sulmuar një tjetër në autobus të transportit publik (i verifikuar)

**Çka ka ndodhur:** Katër të mitur kanë sulmuar një tjetër të mitur në një autobus të transportit publik nr. 65, dhe kanë shkaktuar ndjenjën e pasigurisë tek pasagjerët tjerë.

**Data, koha dhe lokacioni i incidentit:** 19 shkurt, ora 14:20 në autobusin nr.65 të transportit publik.

**Burimi i informacionit:** Mediumi nacional elektronik kajgana.mk.

**Viktima(t) e përfshirë:** Një vajzë e moshës 17 vjeçare me përkatësi etnike të panjohur është sulmuar fizikisht dhe është ngacmuar.

**Lloji i krimit(ve):** Dhunë, neni. 386 KPRM, lëndim truporë, neni. 130 KPRM.

**Kryerësi(t):** Katër djem të rinjë me përkatësi etnike të panjohur.

**Përshkrimi i shkurtër i incidentit me treguesit e anshmërisë:** Në këtë incident, motivi i anshmërisë është përkatësia etnike, nacionale ose gjuhësore, ndërsa treguesit e anshmërisë janë:

1. *Dallimi i supozuar etnik në mes kryesit të veprës dhe viktimës* - Për shkak të përbërjes etnike të popullatës në fshatin e Nikishtan (fshat në të cilin autobusi Nr.65 udhëton), përkatësia e viktimës mund të dallojë nga ajo e kryerësit.

2. *Modeli / Frekuenca e incidenteve të mëparshme* – Incidenti ka ndodhur në transport publik i cili udhëton në drejtim të një komuniteti të përzier ose shumicë shqiptare, i cili paraqet incidentin e tretë në më pak se dy muaj.

3. *Natyra e dhunës* – Incidenti ka ndodhur publikisht.

**Statusi i rastit:** Është ngritur akuzat.

**Reagimi i autoriteteve lokale:** Policia nëpërmjet mediave ka deklaruar se kanë ngritur padi penale për aktin e "Dhunës".

**Ndikimi në viktim(-at) dhe komunitet:** Ky lloj i incidenteve sjell në pikëpyetje sigurinë e përgjithshme në vend dhe bashkëjetesën mes maqedonasve, në njërën anë dhe shqiptarëve si dy bashkësive më të mëdha etnike në vend.

### 15. Nxënës të klasës së tetë përleshën në një shkollë në Kumanovë (i pa verifikuar)

**Çka ka ndodhur:** Katërmbëdhjetë të mitur dhe një mësues nga shkolla fillore Bajram Shabani janë sulmuar dhe ofenduar nga një grup i nxënësve nga shkolla fillore Braqa Miladinovci, pas një aktiviteti të përbashkët projekti.

**Data, koha dhe lokacioni i incidentit:** 20 shkurt, ora 13:30 afër shkollës fillore Bajram Shabani në Kumanovë.

**Burimi i informacionit:** Mediumi nacional elektronik Plusinfo.

**Viktima(t) e përfshirë:** Katërmbëdhjetë të mitur dhe një mësues nga shkolla fillore Bajram Shabani, në Kumanovo.

**Lloji i krimit(ve):** Dhunë, neni. 386 KPRM, lëndim truporë, neni. 130 KPRM, pjesëmarrje në përleshje neni.132 KPRM.

**Kryerësi(t):** një grup i nxënësve nga shkolla fillore Braqa Milladinovci në Kumanovë.

**Përshkrimi i shkurtër i incidentit me treguesit e anshmërisë:** Në këtë incident, motivi i anshmërisë është përkatësia etnike, nacionale ose gjuhësore, ndërsa treguesit e anshmërisë janë:

1. *Dallimi i supozuar etnik në mes kryesit të veprës dhe viktimës* - Për shkak të përbërjes së përzier etnike të shkollave që nxënësit ndjekin, përkatësia etnike e viktimave mund të ndryshojë nga ajo e njërit prej autorëve të krimit.

2. *Komente* – Përleshjes i ka pasuar edhe ofendimi (tema e paspecifikuar).

3. *Lokacioni dhe koha* – Incidenti ndodhi në prezencën e një numri të vogël nxënësish (maqedonas etnik) në një shkollë fillore kryesisht shqiptare.

4. *Natyra e dhunës* – Incidenti ka ndodhur publikisht.

**Statusi i rastit:** I/e panjohur.

**Reagimi i autoriteteve lokale:** Pasi Komiteti dërgoi një Kërkesë për informacion publik, Policia u përgjigj se ata kishin sqaruar rastin, por nuk specifikonin asgjë për motiv të mundshëm apo hapat që ka ndërmarrë.

**Ndikimi në viktim(-at) dhe komunitet:** Ky lloj i incidenteve sjell në pikëpyetje gjendjen e përgjithshme politike në vend dhe bashkëjetesën mes maqedonasve, në njërën anë dhe shqiptarëve në anën tjetër si dy bashkësi etnike më të mëdha në vend, gjithashtu ndikon në ndërtimin dhe ngritjen e një tolerance ndëretnikemes të rinjëve.

### 16. Sulmohen pa arsye dy të rinjë në rrugë (i pa verifikuar)

**Çka ka ndodhur:** Në orët e vonëshme, dy të rinjë, pa ndonjë arsye janë sulmuar nga një grup i përbërë prej 6 njerëzve.

**Data, koha dhe lokacioni i incidentit:** 20 shkurt, 02:00 pas mesnate në rrugën Anton Dimitrov në Draçevë, Shkup.

**Burimi i informacionit:** Mediumi nacional elektronik mkd.mk.

**Viktima(t) e përfshirë:** Dy të rinjë (19 dhe 17) me përkatësi etnike të panjohur janë sulmuar dhe pësuar lëndime të dukshme në fytyrë dhe kokë.

**Lloji i krimit(ve):** Dhunë, neni. 386 KPRM, lëndim truporë, neni.130 KPRM.

**Kryerësi(t):** Një grupë nga 6 persona me përkatësi etnike të panjohur.

**Përshkrimi i shkurtër i incidentit me treguesit e anshmërisë:** Në këtë incident, motivi i anshmërisë është përkatësia etnike, nacionale ose gjuhësore, ndërsa treguesit e anshmërisë janë:

1. *Dallimi i supozuar etnik në mes kryerës të veprës dhe viktimës* - për shkak të përbërjes së përzier etnike të popullatës në fushën e Draçevës, përkatësia etnike e viktimës mund të ndryshojë nga ajo autorit të krimit.

2. *Natyra e dhunës* - incidenti ka ndodhur publikisht.

**Statusi i rastit:** Janë ngritur padi për kundërvajtje.

**Reagimi i autoriteteve lokale:** Pasi Komiteti i dërgoi një Kërkesë për informacion publik, policia u përgjigj se ata kishin sqaruar rastin, por nuk specifikonin asgjë për motiv të mundshëm. Gjithashtu, autorëvetë krimit u janë ngritur padi për kundërvajtje kundër rendit dhe qetësisë publike.

**Ndikimi në viktim(-at) dhe komunitet:** Ky lloj i incidenteve sjell në pikëpyetje sigurinë e përgjithshme në vend dhe bashkëjetesën mes maqedonasve, në njërin anë dhe shqiptarëve si dy bashkësi etnike më të mëdha në vend.

## 17. Rrahje masive në mes nxënësve të shkollës fillore Zef Lush Marku në Shkup (i pa verifikuar)

**Çka ka ndodhur:** Tri grupe të nxënësve janë përleshur në shkollën fillore Zef Lush Marku në Shkup.

**Data, koha dhe lokacioni i incidentit:** 21 shkurt, në shkollën fillore Zef Lush Marku në Shkup.

**Burimi i informacionit:** Mediumi nacional elektronik Inpress.

**Viktima(t) e përfshirë:** Një nga fëmijët, me përkatësi etnike të panjohur, ka marrë gërvishje në fytyrë.

**Lloji i krimit(ve):** Dhunë, neni. 386 KPRM, lëndim truporë, neni. 130 KPRM, pjesëmarrje në përleshje, neni.132 KPRM.

**Kryerësi(t):** 16-17 nxënës nga shkolla fillore me përkatësi etnike të panjohur kanë marrë pjesë në rrahjen.

**Përshkrimi i shkurtër i incidentit me treguesit e anshmërisë:** Në këtë incident, motivi i anshmërisë është përkatësia etnike, nacionale ose gjuhësore, ndërsa treguesit e anshmërisë janë:

1. *Dallimi i supozuar etnik në mes kryerës të veprës dhe viktimës* - Për shkak të përbërjes së përzier etnike të shkollës që ndjekin nxënësit, përkatësia etnike e viktimave mund të dallojë nga ajo e njërit prej autorëve të krimit.

2. *Natyra e dhunës* - Incidenti ka ndodhur publikisht.

**Statusi i rastit:** Kryerësit janë lokalizuar.

**Reagimi i autoriteteve lokale:** Pasi Komiteti dërgoi Kërkesë për informacion publik, policia u përgjigj se ata kishin sqaruar rastin, dhe kanë përfunduar dokumentacionin e duhur për rastin, mirëpo nuk specifikon asgjë në lidhje me motiv të mundshëm.

**Ndikimi në viktim(-at) dhe komunitet:** Ky lloj i incidenteve sjell në pikëpyetje gjendjen e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën mes maqedonasve, në njërin anë dhe shqiptarëve në anën tjetër si dy bashkësi më të mëdha etnike në vend.

## 18. Nxënësi i sulmuar në Kumanovë (i pa verifikuar)

**Çka ka ndodhur:** Një nxënës 17 vjeçar nga Kumanova, duke u kthyer për në shtëpi nga shkolla është sulmuar nga tri nxënës nga shkolla Krste Misirkov në Kumanovë. Në një çast, kryerësit kanë nxjerrë thikë, mirëpo viktima ka arritur të ikë.

**Data, koha dhe lokacioni i incidentit:** 21 shkurt, në bulevardin Narodna Revolucija pranë shkollës fillore Krste Misirkov në Kumanovë.

**Burimi i informacionit:** Mediumi nacional elektronik Netpress.

**Viktima(t) e përfshirë:** Një nxënës 17 vjeçar me përkatësi etnike të panjohur.

**Lloji i krimit(ve):** Dhunë, neni. 386 KPRM, lëndim truporë, neni.130 KPRM.

**Kryerësi(t):** Një grup prej 3 nxënësve të shkollës fillore me përkatësi etnike të panjohur.

**Përshkrimi i shkurtër i incidentit me treguesit e anshmërisë:** Në këtë incident, motivi i anshmërisë është përkatësia etnike, kombëtare ose gjuhësore, ndërsa treguesit e anshmërisë janë:

1. *Dallimi i supozuar etnik në mes kryerës të veprës dhe viktimës* - Për shkak të përbërjes së përzier etnike të nxënësve që ndjekin shkollat, përkatësia etnike e viktimave mund të dallojë nga ajo e njërit prej autorëve të krimit

2. *Natyra e dhunës* - Incidenti ka ndodhur publikisht.

3. *Mungesa e motiveve tjera.*

**Statusi i rastit:** Janë ngritur akuzat për kundërvajtje.

**Reagimi i autoriteteve lokale:** Autoritetet deklaruan nëpërmjet mediave se ata po merrin masa për sqarimin e rastit. Pasi Komiteti dërgoi Kërkesë për informacion publik, policia u përgjigj se ata kishin sqaruar rastin dhe se kishin sjellë kallëzime kundërvajtëse për të miturit. Policia nuk ka saktësuar asgjë rreth motivit të mundshëm.

**Ndikimi në viktim(-at) dhe komunitet:** Ky lloj i incidenteve sjell në pikëpyetje gjendjen e përgjithshme politike në vend dhe bashkëjetesën mes maqedonasve, në njërin anë dhe shqiptarëve si dy bashkësive më të mëdha etnike në vend, po ashtu ndikon në ndërtimin e një tolerante shumetnike në mes të rinjëve.

## 19. Vandalizohen njëzët varreza ortodokse në fshatin Brnjarci (i verifikuar)

**Çka ka ndodhur:** Në një ditë feste ortodokse, kryerës të panjohur kanë vandalizuar përafërsisht 20 varreza.

**Data, koha dhe lokacioni i incidentit:** 22 shkurt, në fshatin Brnjarci (i cili kufizohet me fshatin Haraqinë) në Shkup.

**Burimi i informacionit:** Mediumi nacional mkd.mk, falanga.mk, novini.mk.

**Viktima(t) e përfshirë:** Përveç dëmit material, nuk ka pasur viktima direkte nga ky incident.

**Lloji i krimit(ve):** Dëmtimi i pronës së huaj, neni. 243 KPRM, vandalizimi i varrezave, neni. 400 KPRM.

**Kryerësi(t):** 1/e panjohur.

**Përshkrimi i shkurtër i incidentit me treguesit e anshmërisë:** Në këtë incident, motivi i anshmërisë është përkatësia fetare dhe bindjet religjioze, ndërsa treguesit e anshmërisë janë:

1. *Perceptimi i viktimës* - Sipas deklaratave të dhëna në media, mund lehtësisht të konstatohet se viktimat indirekt - popullsia maqedonase në fshatin Brnjarci, e percepton këtë incident si të motivuar nga paragjykimi.

2. *Lokacioni dhe koha* - Incidenti ka ndodhur në një ditë feste fetare dhe ka ndodhur në një lokacion me rëndësi fetare.

3. *Modeli i incidenteve të mëparshme* - Viktima indirekte deklaroi se kësi lloje incidentesh ndodhin gatisë në çdo funeral dhe festat ortodokse.

**Statusi i rastit:** Nën hetim.

**Reagimi i autoriteteve lokale:** Rasti është raportuar tek autoritetet.

**Ndikimi në viktim(-at) dhe komunitet:** Ky lloj i incidenteve sjell në pikëpyetje gjendjen e përgjithshme të sigurisë në vend dhe bashkëjetesën mes maqedonasve, në njërin anë dhe shqiptarëve si dy bashkësive më të mëdha etnike në vend.

## 20. Eksplozon një bombë para zyrës së degës së LSDM në Karposh (i pa verifikuar)

**Çka ka ndodhur:** Një bombë e gjuajtur nga një veturë në lëvizje ka eksploduar në zyrë e degës së Lidhjes Social Demokrate (LSDM), derisa në atë moment më shumë se tridhjetë anëtarë të rinisë së partisë kanë mbajtur takimin aty brenda.

**Data, koha dhe lokacioni i incidentit:** 24 shkurt, orët e mbrëmjes në rrugën Varshavska në komunën e Karposhit, Shkup.

**Burimi i informacionit:** Mediumi nacional TV Telma.

**Viktima(t) e përfshirë:** Përveç dëmit material, nuk ka pasur viktima direkte nga ky incident. Mund të thuhet se viktimat e përcaktuara ishin njerëzit brenda atij lokali.

**Lloji i krimit(ve):** Dëmtimi i pronës së huaj, neni. 243 KPRM, rrezikim i sigurisë, neni. 144 KPRM.

**Kryerësi(t):** I/e panjohur.

**Përshkrimi i shkurtër i incidentit me treguesit e anshmërisë:** Në këtë incident, motivi i anshmërisë është anëtarësimi partiak dhe bindjet politike, ndërsa treguesit e anshmërisë janë:

1. *Perceptimi i viktimës* – Nga deklaratimet në media, mund të konstatohet lehtë se viktimat (indirekte) – përfaqësuesit nga LSDM, e perceptojnë incidentin, si të motivuar nga anshmëria.

2. *Lokacioni dhe koha* – Incidenti ka ndodhur gjatë një takimi të forumit rinor të LSDM.

3. *Natyra e dhunës* – Incidenti ka ndodhur publikisht.

4. *Mungesa e motiveve tjera.*

**Statusi i rastit:** Nën hetim.

